



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.59

2004

20 gusht

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.538, datë 12.8.2004	Për miratimin e strategjisë kombëtare të zhvillimit të arsimit parauniversitar, 2004-2005.....	3803
Vendim i KM nr.539, datë 12.8.2004	Për miratimin e modelit transitor të tregut të energjisë elektrike	
Vendim i KM nr.540, datë 12.8.2004	Për ristrukturimin e KESH sh.a.-së dhe për një ndryshim në vendimin nr.171, datë 19.4.2002 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e dokumentit të politikave të sektorit elektroenergjetik".....	
Vendim i KM nr.541, datë 12.8.2004	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Koresë, për huatë nga fondi i bashkëpunimit për zhvillim ekonomik dhe të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Koresë, për një hua nga fondi i bashkëpunimit për zhvillim ekonomik	
Vendim i KM nr.542, datë 12.8.2004	Për statusin e ushtarakut me gradë madhore të Forcave të Armatosura pas daljes në lirim.....	
Vendim i KM nr.543, datë 12.8.2004	Për rritjen e pagesës kalimtare të ushtarakut në rezervë (lirim)..	

Vendim i KM nr.544, datë 12.8.2004	Për miratimin e procedurës dhe të dokumentit të legalizimit të shtesave në ndërtime.....
Vendim i KM nr.545, datë 12.8.2004	Për disa shtesa në vendimin nr.722, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”, të ndryshuar.....
Vendim i KM nr.547, datë 12.8.2004	Për një ndryshim në vendimin nr.485, datë 16.7.2004 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e fondeve buxhetore bashkisë së Elbasanit, për mbulimin e shpenzimeve administrative të qendrës sociale “Balashe””
Vendim i KM nr.548, datë 12.8.2004	Për një ndryshim limiti në fondet e kushtëzuara, miratuar në Buxhetin e vitit 2004, për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrinë e Mbrojtjes.....
Vendim i KM nr.550, datë 12.8.2004	Për një ndryshim në vendimin nr.329, datë 12.7.1999 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investitorëve strategjikë dhe për transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë”
Vendim i KM nr.551, datë 12.8.2004	Për disa shtesa në vendimin nr.334, datë 29.5.2003 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Piraj-Kthesa Vau i Dejës, pjesë e superstradës Lezhë-Shkodër”
Vendim i KM nr.552, datë 12.8.2004	Për disa shtesa në vendimin nr.246, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Balldre-Piraj, pjesë e superstradës Lezhë-Shkodër”
Vendim i KM nr.553, datë 12.8 2004	Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve të koncesionit për ndërtimin dhe përdorimin e rafinerive, naftës-jellësve e gazsjellësve
Vendim i KM nr.554, datë 2.7.2004	Për njësimin e gradave ushtarake në funksionet organike në të gjitha nivelet e hierarkisë së komandimit dhe të drejtimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.....
Vendim i KM nr.555, datë 16.7.2004	Për një shtesë fondi në buxhetin e viti 2004, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar komune, në komunën Hudenisht të qarkut të Korçës.....

VENDIM
Nr.538, datë 12.8.2004

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR, 2004-2005

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strategjisë kombëtare të zhvillimit të arsimit parauniversitar 2004-2005.
 2. Ngarkohet Ministri i Arsimit dhe i Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.539, datë 12.8.2004

PËR MIRATIMIN E MODELIT TRANSITOR TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 53 pika 2 e 54 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e modelit transitor të tregut të energjisë elektrike, sipas materialit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohet Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MODELI TRANSITOR I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Përkufizime mbi termat e përdorura në modelin transitor të tregut

MTT-Modeli transitor i tregut
BE-Bashkimi Europian
QSH-Qeveria e Shqipërisë
REM-Tregu rajonal i energjisë (Regional Energy Market)
DDC-Distribution Company (kompania ose divizioni i shpërndarjes)
TSMO-Transmission Sistem Operator (operatori i sistemit të transmetimit-OST)
KESH-Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
NEMD-Tregu me shumicë i energjisë elektrike
PPA-Power Purchase Agreement (marrëveshje shitblerje energjie)

IPP-Independent Power Production (prodhues i pavarur i energjisë)
NDC-National Dispatching Center (qendra kombëtare dispeçer)
PGC-Public Generation Company (kompani publike prodhimi)
SPP-Small Power Plant (prodhues të vegjël të energjisë)
KK-Klientë të kualifikuar
ERE-Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike

HYRJE

Struktura fillestare e MTT-së synon të jetë një fazë transitore, që siguron fleksibilitet për tregun shqiptar që të zhvillohet drejt përmbushjes së plotë të direktivave të BE-së dhe tregut rajonal të energjisë elektrike të parashikuara nga Memorandumi i Athinës II. Meqë evolucioni do të varet më pak nga afatet kohore dhe më shumë nga arritjet aktuale me mekanizmat e tregut, pritet që faza fillestare të përfundojë përafërsisht për 2-3 vjet. Sa më shpejt që vendi të plotësojë kërkesat kritike për stadin tjetër, përfshirë një qendër kombëtare dispeçer, plotësisht operative, fluks transparent dhe eficient të fondeve dhe ndarje të llogarive, tregti me import dhe eksport të orientuar nga tregu që ruan përfitimet e klientëve dhe një proces më të kujdesshëm të parashikimit të ngarkesës, atëherë sektori elektrik do të jetë i aftë të shkojë drejt modelit të aksesit të rregulluar të palëve të treta dhe të rrisë numrin e klientëve të kualifikuar. Progresi i sektorit elektrik drejt zhvillimit të tregut duhet vlerësuar çdo vit me qëllim të vendosjes së objektivave më të qarta për zhvillimin e mëtejshëm të tregut, bazuar mbi progresin e bërë deri në momentin e këtij vlerësimi.

Një synim i rëndësishëm gjatë fazës transitore është lëvizja nga struktura aktuale e KESH-it (kompani vertikalisht e integruar pa llogari të ndara) në kompani gjenerimi, shpërndarjeje dhe transmetimi ligjërisht, funksionalisht dhe financiarisht të ndara. Ky synim është jo vetëm në përputhje me politikat e Qeverisë shqiptare, por dhe i domosdoshëm për të plotësuar kërkesat e direktivave të BE-së 2003/54/BE. MTT-ja siguron një mekanizëm për transicionin në këtë status të ndarë dhe zhvillimin nga faza fillestare me një blerës të vetëm në një model më të fuqishëm që përfshin klientët e kualifikuar dhe akses të rregulluar.

A. Synimet dhe objektivat

1. Direktiva e BE-së dhe Memorandumi i Athinës II

Vendi ynë aspiron të bashkohet me BE-në. Marrëveshja përshkruhet si “një synim i rëndësishëm kombëtar” në dokumentin e politikave të sektorit të energjisë elektrike të miratuar nga QSH-ja në prill 2002. Vendi ynë është palë e Memorandumit të Athinës dhe është angazhuar të bashkëpunojë për krijimin e një tregu rajonal të energjisë elektrike (REM) në Europën Juglindore. Përmbushja e kërkesave minimale të direktivave të aplikueshme të BE-së (Direktiva 2003/54/BE në veçanti) dhe e kërkesave të Memorandumit të fundit të Athinës, të miratuara në dhjetor 2003 (Memorandumi i Athinës II), si dhe përfitimi nga të drejtat në kuadrin e direktivave dhe Memorandumit të Athinës II janë objektiva të rëndësishme për sektorin elektroenergjetik. Megjithatë, gjatë fazave fillestare të periudhës së transicionit janë reflektuar atributet dhe mangësitë e sistemit ekzistues në zgjedhjen e një modeli tregu.

2. Përfitimet e konsumatorit

Zgjedhja e një modeli tregu dhe lëvizja drejt tregjeve kombëtare dhe rajonale të energjisë elektrike duhet të krijojnë përfitime për konsumatorët nëpërmjet përmirësimit të qëndrueshmërisë së shërbimit me tarifa jodiskriminuese, si dhe të reflektojnë kostot ekonomike. Gjatë periudhës së transicionit, tarifat e rregulluara duhet të reflektojnë në mënyrë më të kujdesshme kostot dhe të japin sinjale më të mira çmimi, duke dekurajuar në këtë mënyrë përdorimet joekonomike të energjisë elektrike dhe duke u siguruar përfitime konsumatorëve nëpërmjet moderimit të nevojës për kapacitete të reja më të shtrenjta. MTT-ja do të zhvillohet në mënyrë që t'i lejojë konsumatorët të zgjedhin në atë shkallë që arrihen edhe kërkesat e tjera, si ajo e një procesi likuidimesh funksionues dhe e një informacioni të saktë mbi çmimet. Një përfitim i rëndësishëm për konsumatorët është gjithashtu edhe qëndrueshmëria e shërbimit, ndërsa ndërprerjet nuk janë me përfitim për ta. Një treg më kompetitiv i energjisë elektrike në periudhën afatgjatë, do të prodhojë qëndrueshmëri në rritje të

shërbimit (dhe do të reduktojë ndërprerjet), duke krijuar kushtet për importimin e energjisë elektrike me çmime konkurruese. Megjithatë, kushtet që gjatë viteve kanë krijuar një situatë që kërkon periudha të gjata ndërprerjeje, nuk do të përmirësohen menjëherë nga adoptimi i asnjë modeli tregu.

3. Pjesëmarrësit komercialisht të aftë

Asnjë treg nuk mund të funksionojë në mënyrë eficiente nëse të gjithë lojtarët e tregut nuk janë komercialisht të aftë. Prandaj, synimi i reformës së përgjithshme të sektorit të energjisë elektrike duhet të reflektojë:

a) Përputhjen me kostot

Pjesëmarrësit e rregulluar të tregut duhet të shlyejnë (dhe të paguajnë) shërbimet e kryera (ose të marra) në bazë të kostove të tyre ekonomike. Kostot përfshijnë të ardhurat e nevojshme për investime, kostot e shërbimit dhe fondet e siguruar për të mbështetur investimet.

b) Eliminimin e ndërsbvencioneve

Me qëllim që të plotësojnë parimet e përputhjes së kostos, ndërsbvencionet për arsye të mirëqenies shoqërore duhen siguruar nga QSH-ja dhe jo nga klientët e tjerë tariforë ose pjesëmarrës të tjerë të sektorit të energjisë elektrike. Sbvencionet ekzistuese duhen identifikuar dhe eliminuar sa më shpejt, përveç kur këto eliminime mund të krijojnë konflikt me synimet e rëndësishme kombëtare si ajo e një tarife uniforme kombëtare për të njëjtën kategori konsumatorësh.

c) Menaxhimi eficient

Menaxhimi eficient i pjesëmarrësve të sektorit është i domosdoshëm për të siguruar aftësinë komerciale të pjesëmarrësve të sektorit të energjisë elektrike. Kostot ekonomike nuk duhet të reflektojnë kostot e tepruara që shkaktohen nga menaxhimi joeficient. Investimet në sektorin e rregulluar duhen bazuar në parimin e kostos më të ulët. Flukset e të ardhurave të pjesëmarrësve të tregut duhet të mbështeten nga një sistem arkëtimesh të përmirësuar, humbjesh të reduktuara dhe tarifa që mbulojnë të gjithë elementët e kostos.

4. Tarifa uniforme kombëtare

Politikat e QSH-së kërkojnë që tarifat për çdo klasë klientësh të jenë uniforme në të gjithë vendin. Nëse ka më shumë se një DDC (kompani e shpërndarjes), ky synim do të bjerë në konflikt me parimin e mosndërsbvencioneve të shprehura më lart në 3(b). Krijimi i më shumë se një DDC-je do të rrisë gjithashtu kostot, do të ulë eficientësinë dhe do të komplikojë pa qenë nevoja procesin rregullues.

5. Pronësia e shtetit mbi asetet e transmetimit dhe të interkonjeksionit

Për arsye të sigurisë shtetërore, politikat e QSH-së kërkojnë pronësi shtetërore mbi asetet e transmetimit dhe të interkonjeksionit me vendet fqinje. Në përputhje me ligjin shqiptar është organizuar një TSMO e ndarë (pika 10), që pritet të bëhet plotësisht operuese në korrik 2004. Deri atëherë si asetet përkatëse, ashtu dhe personeli kryesor operues do të jenë transferuar nga KESH-i. Funksioni i TSMO-së sipas MTT-së do të kryhet nga kjo kompani e ndarë shtetërore. Funksionet e gjenerimit dhe të shpërndarjes aktualisht mbeten pjesë e KESH-it, por paraprakisht po ndahen funksionalisht në pritje të privatizimit final, në rast se privatizimi është me lehtësi ekonomike dhe sjell përfitim publik. MTT-ja i parashikon funksionet e gjenerimit dhe të shpërndarjes si divizione të KESH-it ose shoqëri (kompani) të ndara.

6. Zhvillimi i tregut me shumicë të energjisë elektrike (WEMD)

Synimi i WEMD-së është një hap i parë logjik drejt një zhvillimi më të përgjithshëm të tregut. WEMD-ja fokusohet kryesisht mbi zhvillimin e REM-it. Për shkak të barrierave për të zhvilluar një treg kombëtar të energjisë elektrike, ky fokusim justifikohet.¹ Për më tepër, REM-i

¹ TSMO e përdorur në këtë dokument nënkupton OST të krijuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.797, datë 4.12.2003 "Për krijimin e kompanisë së operimit të sistemit".

Këto barrierat rezultojnë nga rrethanat e mëposhtme:

1. Sistemi i përgjithshëm elektrik është i vogël. Prandaj, potenciali për blerës të shumë konkurrues vendës (DDC) është i kufizuar.

2. Klientët industrialë janë një pjesë në rënie e miksit total të gjenerimit. Prandaj, numri i klientëve të kualifikuar potencialë është i kufizuar.

duhet t'i ofrojë gjeneruesve në rajon (dhe konsumatorëve në një shkallë më të kufizuar) një mundësi për të zhvilluar eksperiencë tregtie, bazuar në kritere të leverdisshme ekonomike. Harmonizimi me REM-in do të çojë përpara, gjithashtu, procesin më të vështirë të liberalizimit të tregut vendas, nëpërmjet futjes së konkurrencës, transparencës dhe inkurajimit të burimeve alternative. WEMD-ja ka potencialin më të madh në periudhën afatshkurtër për të rritur qëndrueshmërinë e shërbimit, sigurinë e furnizimit mbi bazën e kostos më të ulët nëse shoqërohet me investime për të përmirësuar sistemin e transmetimit dhe interkonjeksionet me vendet fqinje. Për shkak të deficitit të madh aktual të energjisë elektrike në Shqipëri dhe të kohës dhe kostove të konsiderueshme që nevojiten për ndërtimin e impianteve të reja të gjenerimit, nuk ekziston asnjë zgjidhje tjetër për periudhën afatshkurtër. Për shkak të paqëndrueshmërisë së paevitueshme të çmimeve në zhvillimin e tregut me shumicë, do të ketë tensione mes WEMD-së dhe parimit të përfitimeve të konsumatorit të përshkruar në paragrafin 2 më lart. MTT-ja e zgjidh këtë konflikt nëpërmjet përdorimit të kontratave të rregulluara njëvjeçare për shumicën e nevojave energjetike të Shqipërisë nga gjenerimi ekzistues i hidroenergjisë me kosto të ulët të zotëruar nga KESH-i, si dhe për kërkesat e shërbimeve ndihmëse të nevojshme me qëllim që të kufizojë dhe të minimizojë pasojat e dëmshme mbi shumicën e konsumatorëve nga rritjet e çmimeve ose nga manipulimet e tregut. Bilanci i nevojave elektroenergjetike të Shqipërisë duhet të mbulohet nga zhvillimi i IPP-ve (prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike), SPP-ve (Centralet e vegjël të energjisë elektrike) nga importet. Modeli i tregut standard REM të propozuar parashikon për TSMO-në vetëm në rolin e blerësit të vetëm të shërbimeve ndihmëse dhe jo të energjisë elektrike. Kur KESH-i të jetë i ndarë nga ana funksionale dhe financiare dhe aspektet e tjera të MTT-së të desinjuar të bëhen operuese, atëherë tregu shqiptar i energjisë elektrike duhet të lëvizë përtej rolit aktual të TSMO-së dhe të lejojë kontrata direkte mes gjeneruesve dhe furnizuesve nga njëra anë dhe klientëve të kualifikuar dhe DDC-ve nga ana tjetër. Kontratat kufizuese deri në një vit parandalojnë ruajtjen e asaj që është sipas disenjimit faza e parë e modelit transitor.

Sigurisht që arsyeja e parë për të marrë në konsideratë reformimin dhe ristrukturimin e tregut elektrik shqiptar është rritja e përfitimit të klientëve. Ridisenjimi i tregut, si i tillë, nuk është synim në vetvete; por ridisenjimi i tregut, përfshirë WEMD-in duhet ndërmarrë vetëm nëse synon të prodhojë përfitime më të mëdha për klientët sesa ekzistojnë në kushtet aktuale.

QSH-ja ka përcaktuar se hyrja në BE do të jetë me përfitim për shqiptarët. Për të arritur përfitimin e klientëve nga kjo hyrje, Shqipëria duhet të plotësojë direktivat e aplikueshme të BE-së dhe Memorandumit II të Athinës. Tregjet konkurruese që do të rezultojnë nga zbatimi si duhet i reformave dhe të strukturave të tregut të kërkuara për hyrjen në BE, do të sigurojnë në periudhën afatgjatë përfitime për klientët, si qëndrueshmëri më të madhe të shërbimit, ndryshueshmëri të vogël çmimesh dhe më shumë zgjedhje të klientëve në shërbim. Konsumatorët do të përfitojnë gjithashtu nga rezultate të tjera të reformave që mund të ulin koston e shërbimit, si: një ndarje më eficiente të kapitalit, eliminimin e subvencioneve shtetërore në sektor, krijimi i pjesëmarrësve të mirëmenaxhuar dhe komercialisht të aftë në sektor. MTT-ja synon të nxisë përfitimet e klientëve dhe të veprojë si hap i parë drejt një ristrukturimi më të madh të tregut që, nëpërmjet REM-it, do të rrisë më shumë përfitimet e klientëve dhe do të reduktojë riskun e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve.

3. Hidro zë 98% të prodhimit vendës të sistemit ose miksit të kapacitetit gjenerues të instaluar pothuaj e gjitha nga 3 centrale në të njëjtën kaskadë që kërkojnë operim të ndërruarur të centraleve. Prandaj, potenciali për një numër kokurruës shitësish vendas është i kufizuar edhe nëse gjenerimi hidro privatizohet.

4. Konsumi kapërcen shumë furnizimin; kufizimi i ngarkesës ndodh gjatë gjithë vitit. "Kërkesa", meqë ky term përdoret zakonisht në parashikimet e ndërtesës së ndërmarrjes, parashikon nivele energjie që konsumatorët dëshirojnë t'i paguajnë. Në Shqipëri, konsumi që përfshin përdorimet e energjisë elektrike për të cilën pagesa nuk bëhet dhe as nuk pritët të bëhet, mund të jetë më e madhe se kërkesa. Ndërsa rriten tarifat për të reflektuar koston aktuale, ndiqen arkëtimet agresive dhe politikat e ndërprerjes për të mbledhur të ardhurat për energjinë elektrike të prodhuar, konsumi dhe kërkesa do të afrohen më shumë.

5. Kapaciteti importues i Shqipërisë kufizohet nga facilitetet e papërshtatshme të transmetimit dhe interkonjeksionit. Ndërsa sinjalet e duhura të çmimit, mbledhja dhe politikat e ndërprerjes afrojnë konsumin me kërkesën, kërkesa për importe mund të reduktohet dhe mund të rezultojë më shumë nga variacionet sezonale në hidro sesa nga konsumi i tepërt.

7. Zhvillimi i IPP-ve, hidrocentraleve të vegjël dhe kogjeneruesve ("CHP")

Siç u diskutua më lart, në tregun vendas shqiptar nuk ka të ngjarë të zhvillohet konkurrencë e rëndësishme gjeneruese në të ardhmen e afërt. Megjithatë, ekzistojnë mundësitë për zhvillim të kufizuar lidhur me prodhimin e vogël të energjisë elektrike dhe kogjenerimit të vogël ose CHP (impianetet e kombinuara të energjisë elektrike dhe termike). Ligji nr.9072 për sektorin e energjisë elektrike (neni 14 kreu 2), që ka hyrë në fuqi në gusht 2003 autorizon ERE-n që të miratojë rregullore për vendosjen e procedurave të thjeshta dhe të përshpejtuara të licencimit për këto centrale të vegjël (5 MW ose më pak).

Gjithashtu, projektregulloret për lehtësimin e elementeve kyç për:

1) licencimin e ndërtimit dhe të operimit; 2) aksesin e hapur të transmetimit; 3) marrëveshjet e shitjes së energjisë për centralet e vegjël duhen përfunduar nga ERE në mbështetje të MTT-së. Metodologjia për vendosjen e çmimit të energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentralet e vegjël duhet të jetë e tillë që të inkurajojë zhvillimin e këtyre centraleve dhe do të sjellë përfitime për konsumatorët. Ky zhvillim është një mjet i fuqishëm për të futur shitësit (tregtuesit) konkurrues në tregun kombëtar dhe duhet inkurajuar për të rritur numrin dhe për të zgjeruar eksperiencën e pjesëmarrësve në treg.

Në varësi të kufizimeve të përshkruara më lart lidhur me sasinë e PPA-ve (kontratave afatgjata të shitje-blerjeve të energjisë elektrike) afatgjata, është i dëshirueshëm gjithashtu edhe zhvillimi i IPP-ve (përfshirë CHP-të) që përfshijnë njësi më të mëdha, veçanërisht nëse gjithë ose një pjesë e energjisë elektrike të prodhuar prej tyre të shitet me çmim tregu.

8. Kufizimet fizike të aseteve gjeneruese, transmetuese dhe shpërndarëse

Reformat e tregut duhet të njohin dhe të reflektojnë aspektet ekzistuese fizike dhe atributet e tyre teknike, si dhe të përfshijnë çdo kufizim të vendosur nga aftësitë e kufizuara të këtyre aseteve. Tre kufizime serioze që pengojnë funksionimin e tregut shqiptar të energjisë janë:

a) Përmirësimi i sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes

Viti 2003, humbjet teknike në sistemet e transmetimit dhe të shpërndarjes ishin përkatësisht 10.9% dhe 15.2% (humbjet në transmetim janë paraqitur sipas strukturës së vitit 2003 të këtij funksioni). Këto janë shumë të larta dhe ilustronjë gjendjen e dobët të mirëmbajtjes së këtyre infrastrukturave kritike.

b) Forcimi i lidhjeve të transmetimit të energjisë elektrike me sistemet fqinje

Integrimi i Shqipërisë në REM dhe së fundmi në rrjetet europiane të energjisë varet nga interkonjeksionet e përmirësuara me vendet fqinje. Lidhjet ekzistuese të transmetimit janë të mbingarkuara dhe përjetojnë humbje të mëdha teknike.

c) Nevoja për një qendër të re kombëtare dispeçer

Aktualisht dobësitë e sistemit dispeçerues janë një arsye tjetër për ndërprerjet e mëdha dhe nivelin e lartë të humbjeve teknike. Deri tani, gjithë aktiviteti për kontrollin e sistemit të energjisë elektrike është manual. Rregullimet e frekuencës bëhen nga kontrolli i frekuencës dhe i ngarkesës në një hidrocentral. Kufizimi i ngarkesës imponohet dhe importet e energjisë elektrike janë nganjëherë të njëjta me kapacitetin maksimal të importit. Për të funksionuar sistemi i energjisë elektrike në mënyrë eficiente, është esenciale të ngrihet një qendër kombëtare dispeçer (NDC), përfshirë rrjetin e telekomunikacionit.

Pra, pavarësisht nga modeli i tregut të zgjedhur, sistemi aktual dispeçerues është ende joefiçent dhe ndikon negativisht në problemet e përgjithshme të ndërprerjeve të larta dhe në nivelet e papranueshme të humbjeve teknike. Sidoqoftë disenjimi përfundimtar i tregut shqiptar të energjisë elektrike, duhet ngritur një qendër kombëtare dispeçer. Derisa qendra dispeçer të bëhet funksionale, mund të jetë e vështirë të integrohet dispeçerimi i energjisë elektrike të blerë nga klientët e kualifikuar dhe si rezultat, zhvillimi i MTT-së përtej fazës së blerësit të vetëm, me qëllim që të plotësojë direktivat e BE-së, mund të vonohet.

9. Kufizimet në burimet njerëzore

Përveç kufizimeve të impianetëve dhe centraleve, reforma e tregut duhet të njohë dhe të menaxhojë burimet njerëzore, duke siguruar trajnim të rëndësishëm për menaxherët dhe punonjësit e kompanive, rregullatorët dhe të stafit të rregullatorit, me qëllim që të zbatojnë me metoda bashkëkohore, duke qenë sa më të aftë teknikisht dhe profesionalisht, ndryshimet materiale në

proceset e sektorit të energjisë elektrike.

10. Ndarja e KESH-it

Në përputhje me dokumentin e politikave të sektorit të energjisë elektrike të miratuar nga QSH-ja në prill 2002, si dhe direktivat e BE-së, KESH-i duhet të ndahet në kompani funksionalisht, ligjërisht dhe financiarisht të veçanta gjenerimi, transmetimi dhe shpërndarjeje. Ndarja e transmetimit është tashmë në proces nëpërmjet krijimit të operatorit të sistemit të transmetimit dhe të tregut (TSMO), siç pasqyrohet në pjesën A.5, sipas ligjit shqiptar është organizuar dhe pritët të bëhet plotësisht operative në korrik 2004, një kompani aksionere e ndarë, aksionet e së cilës do të jenë në pronësi të KESH-it, një kompani shtetërore “holding”. Një ndarje e ngjashme duhet edhe lidhur me asetet e gjenerimit dhe shpërndarjes. Për të siguruar që tregu të operojë në mënyrë jodiskriminuese, TSMO-ja duhet të jetë operativisht e pavarur nga KESH-i. Një synim kryesor i MTT-së është lehtësimi dhe inkurajimi i kësaj ndarje, në mënyrë që të identifikojë dhe të ndajë kostot, të instalojë matësat, të nxisë transparencën dhe të lehtësojë transaksionet e drejtuara nga tregu që kanë leverdi nga ana ekonomike.

B. Pjesëmarrësit dhe karakteristikat e modelit transitor të tregut

MTT-ja siguron transicionin drejt një tregu më konkurrues. Ky model më pak i përgjithshëm se modelet më tradicionale, minimizon kostot, lejon zhvillimin në rritje të eksperiencës në aktivitetet e tregtisë, balancon objektivat e përshkruara në kapitullin A për periudhën afatshkurtër dhe duhet ta pozicionojë sektorin elektrik për të lëvizur drejt një tregu që përmbush direktivat e BE-së.

MTT-ja propozon një strukturë dhe rregulla të thjeshta tregu, që mund të zbatohen në një periudhë shumë të shkurtër kohe me nevoja minimale për hardware, software (programe kompjuterike) procese të reja dhe trajnim stafi. Megjithatë, këto nevoja (veçanërisht nevoja për një qendër kombëtare dispeçer) duhen plotësuar në mënyrë që modeli tranzitor i tregut të operojë me efikasitet maksimale dhe të zhvillohet më tej për të përmbushur plotësisht direktivat e BE-së.

1. Pjesëmarrësit e tregut

a) Kompania publike e operatorit të sistemit të transmetimit (TSMO)

TSMO-ja, kompani e pavarur shtetërore që zotëron, mban, operon dhe zgjeron sistemin e transmetimit. TSMO-ja përcakton në bazë vjetore kërkesat për burimet e qëndrueshmërisë së sistemit “must run” dhe nëpërmjet kontratave vjetore dypalëshe blen të gjithë energjinë elektrike që i duhet divizionit ose kompanisë së shpërndarjes (DDC) për të furnizuar klientët tarifarë dhe shërbimet ndihmëse të nevojshme që lidhen me ta. Blerjet nga furnizuesit e jashtëm (importet) do të bëhen sipas një procesi transparent ankandi ose ofertash konkurruese nën mbikëqyrjen rregullatore të ERE-s, sipas rregullave të tregut të miratuara nga ERE². TSMO-ja do të kompensohet nga DDC-ja për blerjen e energjisë elektrike, përfshirë shërbimet ndihmëse sipas një marrëveshjeje për kontratën e shërbimeve (CSA) të aprovuar nga ERE. Përveç marrëveshjes për të paguar TSMO-në për kontratën e shërbimeve, CSA-ja do t’i kërkojë DDC-ve të paguajnë direkt çdo furnizues të energjisë elektrike menjëherë pasi të kenë marrë një raport nga TSMO-ja që tregon shumën dhe koston e energjisë elektrike të furnizuar dhe certifikatën nga TSMO-ja se energjia elektrike ose shërbimet janë siguruar vërtet. Kompensimi i dhënë sipas CSA-së do të jetë ekskluziv dhe TSMO-ja, punonjësit e tij, agjentët dhe personat e caktuar nuk do të marrin kompensim tjetër nga DDC-ja, PGC-ja, furnizuesi i jashtëm ose ndonjë agjent ose palë e tretë lidhur me blerjen e energjisë elektrike nga TSMO-ja.

Me zhvillimin e MTT-së, pritët që roli ndërmjetës i TSMO-së si kontraktor i energjisë elektrike të zvogëlohet dhe së fundi të reduktohet thjesht me sigurimin dhe blerjen e shërbimeve ndihmëse, në përputhje me rolin e përcaktuar të TSMO-së dhe TSO-ve në REM-in e propozuar.

b) Kompania publike gjeneruese (PGC)

PGC-ja do t’i shesë TSMO-së: (1) shërbime ndihmëse dhe energji elektrike të gjeneruar nga njësitë ekzistuese hidro me çmime të rregulluara sipas kontratave vjetore dypalëshe dhe (2) energji elektrike shtesë të kërkuar nga TSMO-ja për të plotësuar ngarkesën e paparashikuar të klientëve

² Termat dhe kushtet për të përcaktuar këto kërkesa dhe dispozitat e këtyre kontratave do të përmbahen në rregullat e tregut ose kodin e rrjetit të skicuar nga pjesëmarrësit e tregut dhe miratuar nga ERE.

tariforë aq sa është e disponueshme. Pritet që PGC-ja të operojë si divizion (ose divizione) i gjenerimit të KESH-it, deri sa të ndahet plotësisht ose të privatizohet. Kur MTT-ja të ketë operuar në mënyrë të suksesshme për një periudhë të arsyeshme kohe (të paktë 18 muaj), PGC-ja mund t'i shesë deri në 5% të kapacitetit nga hidrocentralet ekzistuese të tregut të eksportit, duke supozuar se ky kapacitet nuk kontraktohet ndryshe, me çmime të parregulluara subjekt të kushteve të përshkruara në paragrafin 4 më poshtë.

Fillimisht, të gjitha përfitimet nga kapaciteti vendas hidroenergjetik do të ruhen për klientët tariforë shqiptarë. Kur tregu të operojë në mënyrë të suksesshme, mund të jetë me fitim futja e një shitësi tjetër të parregulluar në treg. Ka mundësi që pjesëmarrja e PGC-së si konkurrues në tregun e parregulluar mund të ketë një efekt pozitiv mbi çmimet për përfitimin e klientëve tariforë. Megjithatë, përsëri edhe kjo pjesëmarrje e ardhshme duhet kufizuar për të ruajtur shumicën e përfitimeve hidroenergjetike për klientët tariforë.

Asgjë në paragrafin b nuk do ta pengojë “shkëmbimin” e energjisë së negociuar nga TSMO-ja me palët në vendet fqinje me terma të përfitimit reciprok që rrisin përfitimet e klientëve. ERE do të zgjidhë çdo mosmarrëveshje nëse këto shkëmbime (vetëm ose bashkë me shkëmbime të tjera) kanë siguruar përfitime për klientët në vend apo jo.

Ky material konceptual parashikon një PGC të vetme, por me ndërtimin e termocentraleve të reja (si ai i Vlorës) dhe rehabilitimin e centraleve të vjetër të Fierit), që do të kontribuojnë më shumë në kuadrin e gjenerimit, do të mund të ketë më shumë se një. Numri i duhur i PGC-ve do të përcaktohet nga një studim që merr në konsideratë përfitimet e klientëve, ndikimin mbi konkurrencën, transparencën, rregullimin efektiv dhe së fundi, privatizimin.

c) Prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike (SPP-të)

Prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike (hidrocentralet dhe kogjeneruesit e vegjël me kapacitet prej pesë ose më pak MW) që mund të licencohen në vend për të shitur kapacitet dhe energji tek TSMO-ja ose tek klientët e kualifikuar me terma komerciale të vendosura ose, nëse nuk mund të arrihet një marrëveshje, me terma të miratuara nga ERE, që lehtësojnë zhvillimin e këtyre projekteve dhe sigurojnë përfitim për konsumatorin.

d) Prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike (IPP-të)

IPP-të (përfshirë CHP-të) me kapacitet mbi pesë MW që mund të zhvillohen dhe licencohen në vend dhe që mund t'u shesin kapacitet ose energji: (1) TSMO-së dhe/ose klientëve të kualifikuar me çmime tregu ose (2) TSMO-së me çmim kontrate të miratuar nga ERE.

e) Furnizuesit e jashtëm

Furnizuesit e jashtëm nënkuptohen ata që janë të vendosur jashtë vendit dhe që eksportojnë energji elektrike te PGC-ja (energji ekonomike), TSMO-ja dhe aq sa lejohet nga ligji dhe rregulloret shqiptare, te klientët e kualifikuar.

f) Divizioni ose kompania e shpërndarjes (DDC)

DDC-ja zotëron, mban, zgjeron dhe operon sistemin e shpërndarjes, duke operuar në të gjithë vendin. Aktualisht DDC-ja është e gjitha pjesë e operimit si divizion i KESH-it.

Për shkak të përmasave të vogla të sistemit elektrik shqiptar, natyrës së sistemit (varësi e jashtëzakonshme nga një burim i vetëm hidroenergjetik në kaskadë, që duhet operuar në mënyrë eficiente si burim gjenerues i vetëm dhe i politikës elektroenergjetike të tarifave uniforme kombëtare me pakicë, funksioni shpërndarës i KESH-it duhet të jetë në jo më shumë se një kompani shpërndarjeje. Një kompani e vetme shpërndarjeje eliminon nevojën për të llogaritur dhe matur diferencat mes humbjeve të transmetimit dhe shpërndarjes për të arritur një tarifë uniforme kombëtare për secilën kategori konsumatorësh dhe (2) për të siguruar më mirë vazhdimësinë, në përshtatje me të gjitha elementet e kostos, heqjes së ndërsuvencioneve dhe tarifave uniforme të përshkruara më lart në pjesën A, paragrafët 3a, 3b dhe 4. Për më tepër, një kompani shpërndarjeje e vetme më e madhe, më e qëndrueshme financiarisht dhe e menaxhuar më mirë, mund të jetë gjithashtu më atraktive për investitorët strategjikë sesa një seri kompanish më të vogla, më pak të sigurta financiarisht për një privatizim të ardhshëm. Investitorët strategjikë janë shumë të rëndësishëm për privatizimin e suksesshëm.

g) Klientët tariforë

Klientët nënkupton ata që blejnë energji elektrike me tarifa të rregulluara vetëm nga DDC që shërben në zonën në të cilën janë vendosur.

h) Klientët e kualifikuar (KK)

Klientët janë ata që kanë aftësinë të blejnë energji elektrike SPP-të, IPP-të dhe furnizuesit e jashtëm. Numri i këtyre klientëve në fillim do të jetë i kufizuar. Aktualisht ligji shqiptar i kufizon KK në klientë që kanë nivele konsumi mbi 100 GWh. Aktualisht, asnjë klient në sistemin e KESH-it nuk ka një ngarkesë që t'i afrohet këtij niveli konsumi. Për të pasur kuptim, niveli i specifikuar i konsumit për kualifikim duhet të ulet për të përfshirë konsumatorët më të mëdhenj të KESH-it (me mbi 50 GWh konsum energji elektrike në vitin paraardhës). Në statet fillestare të zhvillimit të tregut të reflektuara nga MTT-ja, klientët e kualifikuar nuk do të blejnë nga PGC-ja. Këto blerje do t'u jepnin atyre akses prioritar në hidroenergjinë me kosto të ulët të PGC-së, që rezervohet me çmime të rregulluara për përfitimin e gjithë klientëve tariforë. Si çështje praktike, numri i KK-ve të zgjedhur për t'u larguar nga sistemi ka të ngjarë të jetë shumë i kufizuar gjatë fazës së parë të MTT-së. Klientët që do të kualifikohen si KK mund të mos duan të heqin dorë nga aksesit për hidroenergji me kosto të ulët të ruajtur për përfitimin e klientëve tariforë. KK-të nuk mund të zgjedhin largimin "pjesërisht" nga sistemi dhe duhet ose të mbeten klientë tariforë ose t'i plotësojnë të gjitha kërkesat e tyre jashtë sistemit.

Për më tepër, derisa një qendër kombëtare dispeçer të bëhet operuese dhe të lehtësohen kufizimet e linjave të transmetimit dhe interkonjeksionit, mund të ketë pengesa fizike dhe teknike për transmetimin dhe shpërndarjen dhe dispeçerimin e energjisë elektrike të KK-ve.

i) Rregullatori i pavarur (ERE)

ERE ka përgjegjësinë për të rregulluar efektivitetin e aktiviteteve të rregulluara të pjesëmarrësve të tregut, sipas rregullave dhe rregulloreve të duhura dhe në përputhje me procedurat transparente. Ligji nr.9072 për sektorin e energjisë elektrike (që hyri në fuqi më gusht 2003) siguron një bazë ligjore për ushtrimin e këtyre përgjegjësisë nga ERE.

2. Lidhjet mes pjesëmarrësve të tregut

Lidhjet dhe roli i pjesëmarrësve të tregut në operimin fizik të modelit transitor të tregut bazohen në kontrata dypalëshe mes pjesëmarrësve të ndryshëm. Shumë prej këtyre kontratave do të jenë subjekt i miratimit dhe i zbatimit të detyrueshëm nga rregullatori i pavarur (ERE). Lidhjet kontraktuale të TSMO-së, KESH-it, DDC-ve, klientëve tariforë, klientëve të kualifikuar, IPP-ve dhe furnizuesve të jashtëm tregohen në shtojcën A. Kontratat që janë objekt i miratimit nga rregullatori janë shënuar me një yll.

3. Karakteristikat esenciale të MTT-së

a) Viti në avancë

Bazuar në parashikime të konsoliduara të ngarkesës të dërguara nga DDC-ja për klientët tariforë dhe nga klientët e kualifikuar për ngarkesat e tyre paraprake, TSMO-ja do të blejë:

i) Shërbime ndihmëse

TSMO-ja do të përgatisë parashikime vjetore të nevojave për shërbime ndihmëse dhe energji dhe do t'ia dorëzojë këto parashikime rregullatorit të pavarur, ERE-s. PGC-ja do t'i ofrojë për shitje TSMO-së shërbime ndihmëse sipas një kontrate vjetore (Marrëveshja vjetore e furnizimit të shërbimeve ndihmëse (AASSA), nga njësitë teknikisht të kualifikuara për t'i siguruar këto shërbime me çmime që nuk kapërcejnë çmimet maksimale të vendosura nga rregullatori i pavarur për këto shërbime. Shërbimet ndihmëse do të përfshijnë balancimin e energjisë. TSMO-ja mund t'i blejë këto shërbime ndihmëse nga PGC-ja ose nga SPP-ja, IPP-të ose furnizuesit e jashtëm për aq sa është e disponueshme.

ii) Energjia

PGC-ja do t'i ofrojë TSMO-së energji që i korrespondon masës së kapaciteteve të mbetura (pas reflektimit të shërbimeve ndihmëse të blera nga TSMO-ja sipas AASSAA), sipas një kontrate vjetore me çmim të rregulluar. TSMO-ja do të jetë e detyruar ta blejë këtë energji të mbetur brenda maksimumeve (Pmax) dhe minimumeve (Pmin) të rekomanduara në marrëveshjen vjetore të furnizimit me energji elektrike (AESAs) për sa kohë është në gjendje t'ia transmetojë këtë energji DDC-ve. Në atë shkallë që energjia e blerë nga PGC-ja sipas AESA është e pamjaftueshme për të

plotësuar nevojat për energji të DDC-ve, TSMO-ja mund të blejë energji shtesë nga PGC-ja, SPP-ja, IPP-të ose furnizuesit e jashtëm. PGC-ja është e detyruar t'ia shesë këtë energji të mbetur TSMO-së përtej Pmax, me çmime të rregulluara, përveç kur PGC-ja do të jetë angazhuar ta shesë energjinë elektrike të mbetur në tregun e eksportit subjekt i kufizimeve të përshkruar në paragrafin 4 më poshtë. TSMO-ja do të ndalohej të blejë më shumë energji sesa nevojitet në mënyrë të arsyeshme për të plotësuar konsumin e parashikuar nga parashikimi i konsoliduar i ngarkesës së klientëve tariforë.

MTT-ja aktuale planifikon kontratat fillestare sipas AESA mes PSG-së dhe TSMO-së dhe nga ana tjetër kontratat e furnizimit mes TSMO-së dhe DCC-së. Kjo strukturë ngrihet sepse vetë KESH-i, aktualisht, nuk është i ndarë në kompani të veçanta gjenerimi dhe shpërndarje. Me zhvillimin e ndarjes, kur degët të jenë ndarë dhe të jenë vendosur sistemet e domosdoshme të sistemit të kontabilitetit dhe matjes, do të jetë e përshtatshme të zhvillohen marrëveshje direkte dhe ligjërisht të detyrueshme mes KESH-PSG-së dhe KESH-DDC-së.

b) Java në avancë

Para çdo jave të marrëveshjes vjetore të furnizimit me energji elektrike (AES) mes TSMO-së dhe KESH-it, TSMO-ja do të përcaktojë sasinë e nevojshme të energjisë nga KESH-i për çdo orë të javës së ardhshme të bazuar në parashikime të rregulluara të ngarkesës të siguruara nga DDC-ja dhe mundësitë për blerje që mund të ketë nga IPP-të ose furnizuesit e jashtëm. Megjithatë, tarifa e rekomanduar e shpërndarjes sipas AESA nuk do të kalojë (ose të jetë më pak se) tarifat maksimale (minimale) të livrimit të rekomanduara në AESA.

c) Axhustimet e një dite në avancë dhe brenda ditës

TSMO-ja, pas parashikimeve të javës në avancë, mund të modifikojë më tej parashikimet e ngarkesës dhe të menaxhojë diferencat mes energjisë së paracaktuar në parashikimin e javës në avancë për blerje sipas AESA, dhe energjisë së kërkuar në parashikimet e azhurnuara të ditës në avancë të bërë nga DDC-ja në rastin kur është më e madhe se kërkesa, duke u përpjekur të blejë ose të shesë energji nga PGC-ja jo sipas AESA me tarifa të rregulluara apo në tregje lokale (IPP) ose rajonale (furnizuesit e jashtëm) me tarifa të parregulluara.

Nëse parashikimet e ditës në avancë tregojnë se kërkohet më shumë energji elektrike shtesë, sesa ajo që mund të sigurohet nga të gjitha burimet e disponueshme, përfshirë IPP-të dhe furnizuesit e jashtëm, DDC-ja do të duhet të organizojë ndërprerje të vazhdueshme për të mbajtur të balancuar sistemin e transmetimit. Përveç kësaj, ndërprerjet mund të jenë gjithashtu të nevojshme, nëse ngarkesat gjatë një dite të dhënë i kapërcejnë shumë parashikimet e ditës në avancë dhe TSMO-ja nuk është në gjendje të prokurojë energji shtesë në baza një orë në avancë. Ky risk është ndoshta risku më i madh në MTT. Nga ana tjetër, është një rrezik që ekziston aktualisht në sistem. Për më tepër, duke formalizuar parashikimet e ngarkesës dhe detyrimet e furnizimit, ekziston mundësia që potenciali për ndërprerje mund të zbutet nëpërmjet menaxhimit më të mirë të tregut dhe sistemit elektrik të furnizimit. Për më tepër, siç është vënë në dukje më parë, zbatimi i një disenjimi racional të tarifave dhe metodologjisë së tarifave, të shoqëruar me tarifa të disenjuara për të shlyer kostot reale dhe të arsyeshme, do të ndihmojë në reduktimin e riskut të ndërprerjeve për shkak të kërkesës së tepërt për furnizim nga burimet e disponueshme.

4. Shitjet e PGC-së të blerës të tjerë

Marrëveshja vjetore e furnizimit me energji elektrike mes PGC-së dhe TSMO-së do të specifikojë sasinë maksimale të kapacitetit të tij (Pmax) që i duhet shitur TSMO-së. Pmax-i do të caktohet për të ruajtur përfitimet e kapacitetit hidroenergjetik me kosto të ulët të KESH-it për klientët tariforë shqiptarë. Megjithatë, PGC-ja mund ta shesë secilin prej kapaciteteve të tij mbi Pmax për çdo muaj në REM me çmime të parregulluara, me kusht që: (1) të ketë marrë një licencë eksporti nga ERE për të shitur energji për një sasi të specifikuar dhe për një periudhë që nuk i kapërcen tre muaj në tregun e eksportit dhe (2) ERE të ketë përcaktuar që termat e kësaj shitjeje nuk do të: (a) reduktojnë përfitimet e përgjithshme të klientëve ose (b) pengojnë detyrimet e PGC-së sipas AESA-së aktuale ose pasuese, ose sipas AASSA-së. PGC-ja do të mbajë riskun komercial dhe të kreditit që shoqërojnë këto shitje dhe të plotësimit të detyrimeve të vazhdueshme për t'i shpërndarë energji TSMO-së sipas AESA-s dhe AASSA-s.

5. Operimet e sistemit të transmetimit dhe tregut

TSMO-ja do të jetë përgjegjëse për operimin, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e sistemit të transmetimit, përfshirë miratimin e skeduleve të dispeçerimit të propozuara nga PGC-ja për të plotësuar kërkesat për livrimin e energjisë në çdo orë dhe skedulet e dispeçerimit të propozuara nga SPP-të, IPP-të dhe furnizuesit e jashtëm për të plotësuar detyrimet e tyre kontraktuale. PGC-ve, klientëve të kualifikuar, SPP-të dhe IPP-ve do t'u kërkohej të regjistrojnë të gjitha kontratat për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike tek TSMO-ja, në mënyrë që TSMO-ja të mund të operojë sistemin e transmetimit në mënyrë të qëndrueshme dhe efëiente. TSMO-ja do të ketë gjithashtu të drejtën të dispeçerojë direkt gjithë kapacitetin e prokuruar sipas AASSA ose sipas marrëveshjeve të furnizimit të shërbimeve ndihmëse të parregulluara. Në rast të emergjencës së sistemit, TSMO-ja mund të japë instruksione dispeçerimi emergjence për të gjitha centralet e gjenerimit në përputhje me procedurat e identifikuar në kodin e rrjetit të përgatitur me kontribut nga pjesëmarrësit e tregut dhe të miratuar e të zbatuar nga ERE.

Dispeçerimi dhe kontrolli i sistemit sipas MTT dhe fluksi i informacionit për ta mbështetur atë ilustrohen në shtojcën B. Flukset e energjisë elektrike në MTT ilustrohen në shtojcën C. Procedurat e operimit të transmetimit, të dispeçerimit dhe të kontrollit do të përcaktohen më tej në kodin e rrjetit.

Më poshtë përshkruhen procedurat tipike të operimit që duhen ndjekur nga TSMO-ja.

a) Dita e operimit

Gjatë ditës së operimit, TSMO-ja do të dispeçerojë njësi të zotëruara nga PGC-ja, SPP-ja dhe IPP-të për të plotësuar ngarkesën dhe do të zbatojë transaksionet e programuara të importit dhe eksportit, bazuar në skedulim orar të dispeçerimit të miratuar tre ditë më parë nga java operuese, të modifikuar gjatë një dite më parë se dita e operimit. TSMO-ja do të ndjekë skedulim të dispeçerimit, të axhustuar për të zgjidhur çdo emergjencë të sistemit si defektet e gjeneruesve ose linjave të transmetimit. Për ta mbajtur sistemin e transmetimit të qëndrueshëm, TSMO-ja do të dispeçerojë gjithë njësitë e gjenerimit që sigurojnë energji balancuese duke përdorur sinjalet AGC. TSMO-ja do të zgjidhë të gjitha emergjencat duke përdorur manualin e operimit të sistemit, duke siguruar vendime transparente të dispeçerimit. Nëse emergjencat e sistemit rezultojnë në flukse të paplanifikuara energjie me sistemet fqinje, këto flukse do të maten. TSMO-ja do të përdorë sistemet SCADA dhe EMS për të regjistruar të dhënat e sistemit, përfshirë regjistrimin dhe matjen e të dhënave në çdo gjenerator, pikat e takimit dhe basbarat e ngarkesave. Me zhvillimin e mekanizmit të REM-it dhe në përputhje me detyrimet e tij, sipas AEES dhe AASSAA, PGC-ja mund të kërkojë të bëjë blerje ekonomike brenda ditës dhe shitje tek SPP-të, IPP-të dhe furnizuesit e jashtëm, si dhe të informojë TSMO-në për ndryshimet ditore të skedulit të dispeçerimit orar.

b) Dita pas ditës së operimit

Në ditën pas ditës së operimit, TSMO-ja do të kontrollojë të gjitha të dhënat e matjes orare nga gjeneratori, pikat e takimit dhe basbarat e ngarkesës për saktësi. Pas kontrollit të të dhënave, TSMO-ja do të shpërndajë deklarata (pasqyra) ditore që përmbajnë të dhënat që u nevojiten PGC-së, SPP-ve, IPP-ve, furnizuesve të jashtëm dhe klientëve të kualifikuar për të llogaritur shumat e detyrueshme sipas kontratave respektive dypalëshe. TSMO-ja do të llogarisë gjithashtu shumat që i ka PGC-së dhe çdo SPP-je, IPP-je ose furnizuesi të jashtëm që kanë furnizuar shërbime ndihmëse. TSMO-ja do t'ia ndajë këto kosto DDC-së dhe klientëve të kualifikuar në bazë të kontributit të tyre proporcional për çdo orë të ngarkesës së sistemit me qëllim që të paguajë kapacitetin për shërbimet ndihmëse. PGC-ja dhe DDC-ja dhe çdo klient i kualifikuar do të paguajnë për energjinë balancuese të përdorur për të furnizuar mungesat dhe disbalancat e tyre.

Për të asistuar TSMO-në në bërjen e parashikimeve të sakta të ngarkesave të sistemit për çdo orë, do të vendosen mekanizma në rregulloren përkatëse të tregut për të siguruar nxitje për DDC-të dhe, eventualisht, për klientët e kualifikuar. Kur ngarkesat në kohë ndryshojnë shumë nga ngarkesat e parashikuara (si për shkak të skedulimit të pasaktë të gjenerimit nga DDC-të, IPP-të dhe furnizuesit e jashtëm, duke shkaktuar ndryshime të mëdha në energjinë e humbur dhe energjinë balancuese të konsumuar, ashtu edhe thjesht për shkak të të dhënave dhe parashikimeve të pasakta nga DDC-ja dhe klientët e kualifikuar), qëndrueshmëria bie. Ato pjesëmarrës tregu që kontribuan në uljen e qëndrueshmërisë dhe disbalancës duhet të penalizohen për të përmirësuar nivelin e saktësisë

së parashikimit të tyre. ERE është e autorizuar të vendosë sanksione ndaj atyre që shkaktojnë dështimin e vazhdueshëm dhe të pajustificueshëm në parashikimin e ngarkesave në mënyrë më të saktë.

c) Dita e pestë e muajit pas ditës së operimit

TSMO-ja do të shpërndajë fatura për çdo pjesëmarrës tregu, duke treguar se sa i detyrohet secili TSMO-së për energjinë balancuese që kanë konsumuar gjatë muajit. Këto fatura do të përfshijnë çdo korigjim nga deklaratat (pasqyrat) ditore të lëshuara ditën pas ditës së operimit, plus pagesat për shërbimet e transmetimit, shërbimet e operimit të sistemit dhe çdo shumë tjetër që i detyrohet TSMO-së nga çdo pjesëmarrës tregu. TSMO-ja do t'u dorëzojë gjithashtu DDC-së një deklaratë (pasqyrë) që tregon sasinë dhe koston e energjisë elektrike që është blerë në emër të tyre nga PGC-ja (sipas dhe jashtë AEES), SPP-ve, IPP-ve dhe furnizuesve të jashtëm. DDC-ja, klientët e kualifikuar, PGC-ja, SPP-ja, IPP-të dhe furnizuesit e jashtëm do të krijojnë sistemin e tyre të dhënave dhe do të likuidojnë faturat dhe llogaritë e tyre në mënyrë të pavarur nga TSMO-ja dhe në përputhje me termat e kontratave të tyre dypalëshe.

d) Dita e dhjetë e muajit pas ditës së operimit

Klientët e kualifikuar, DDC-ja, PGC-ja dhe IPP-ja do të paguajnë të gjitha shumat që i detyrohen TSMO-së sipas faturave të shpërndara nga TSMO-ja. Për më tepër, DDC-ja do t'i paguajnë direkt PGC-së, SPP-ve, IPP-ve ose furnizuesve të jashtëm koston e energjisë elektrike të blerë nga TSMO-ja siç tregohet në deklaratën e dhënë DDC-së nga TSMO-ja sipas paragrafit paraardhës c. Ndërsa DDC-ja dhe PGC-ja mbeten pjesë e sistemit të KESH-it, transaksionet mes njërive të ndryshme funksionale të KESH-it (gjenerimit, transmetimit dhe shpërndarjes) mund të reflektohen nga llogaritë e duhura hyrëse.

Të gjitha aspektet e operimit të sistemit të transmetimit dhe të tregut duhet të funksionojnë në mënyrë transparente me analiza rregullatore nga ERE për të eliminuar çdo dyshim për korrupsion që do të sabotonte përpjekjet për zhvillimin e tregut. Rregullat e tregut dhe kodet që lidhen me to duhet të sigurojnë jo vetëm fleksibilitet që tregu të operojë në mënyrë eficiente, por gjithashtu edhe mbrojtje efektive kundër mundësisë së korrupsionit.

6. Fluksi i fondeve

Fluksi i fondeve në modelin transitor të tregut tregohet në shtojcën D. Duhet vënë në dukje se, për sa kohë funksionet e gjenerimit dhe të shpërndarjes mbeten në varësi dhe të konsoliduara në sistemin e KESH-it, ka të ngjarë të mos ndodhë asnjë transferim fizik fondesh lidhur me pagesat nga DDC-ja tek PGC-ja. Për shembull, këto pagesa, mund të ndahen, sipas hyrjeve të duhura kontabël, si të ardhura të funksionit të gjenerimit dhe shpenzime të funksionit të shpërndarjes. Fluksi i fondeve për pjesëmarrësit kryesorë të tregut është përmbledhur si vijon:

a) TSMO-ja:

i) Të pagueshme: TSMO-ja do të paguajë faturat nga PGC-ja, SPP-të, IPP-të dhe furnizuesit e jashtëm për shërbimet ndihmëse;

ii) Të arkëtueshme: (a) DDC-ja dhe klientët e kualifikuar do t'i paguajnë TSMO-së për:

1) pjesën e tyre proporcionale të shërbimeve ndihmëse;

2) pagesat e transmetimit të llogaritura në përputhje me tarifën e përfshirë në marrëveshjen për shërbimet e transmetimit, të miratuara nga ERE;

3) TSMO-ja do t'i faturojë gjithashtu klientëve të kualifikuar për shërbimet balancuese si në bazë të kapacitetit, ashtu dhe të balancës së energjisë.

b) Kompania publike gjeneruese:

iii) Të pagueshme:

a) PGC-ja do t'i paguajë TSMO-së për shërbimin e transmetimit të siguar sipas tarifave të miratuara nga ERE;

b) PGC-ja do t'i paguajë IPP-ve dhe furnizuesve të jashtëm për blerjet e energjisë ekonomike (që do të thotë, energji që mund të jetë e disponueshme në kohë të caktuar të ditës ose vitit dhe që mund të blihet më lirë nga sa mund ta prodhonte PGC-ja dhe që mund të përdoret ekonomikisht për nevojat e centralit ose për të plotësuar detyrimet kontraktuale).

iv) Të arkëtueshme:

a) TSMO-ja do t'i paguajë PGC-së për shërbimet ndihmëse;

b) DDC-ja do t'i paguajë PGC-së për energjinë elektrike me tarifa të rregulluara;
c) Klientët e kualifikuar dhe furnizuesit e jashtëm do t'i paguajnë PGC-së për energjinë elektrike deri në atë nivel që këto shitje lejohen.

c) Divizionet ose kompanitë e shpërndarjes:

i) Të pagueshme:

ii) (a) DDC-ja do t'i paguajë PGC-së për të gjithë energjinë elektrike të blerë nga TSMO-ja dhe të furnizuar klientëve tariforë (furnizuar sipas AESA-s ose ndryshe) në bazë të energjisë elektrike të livruar në sistem nga PGC-ja (humbjet e transmetimit do të përfshihen);

b) DDC-ja do t'u paguajë SPP-ve, IPP-ve dhe furnizuesve të jashtëm për energjinë elektrike të blerë në emër të tyre nga TSMO-ja në atë shkallë që këto kosto janë reflektuar në tarifat e klientëve tariforë të miratuara nga ERE. (TSMO-ja është e ndaluar të blejë energji elektrike nga këto burime më tepër se ç'mund të shlyhet nga tarifat);

c) DDC-ja do t'i paguajnë TSMO-së pagesat për shërbimet e transmetimit për transmetimin e energjisë elektrike sipas një tarfie transmetimi të bazuar në kosto të miratuar nga ERE.

ii) Të arkëtueshme:

Klientët tariforë do t'i paguajnë DDC-së për energjinë elektrike që u është livruar atyre sipas një kontrate furnizimi dhe shpërndarje me tarifa të miratuara nga ERE. Këto tarifa do të bazohen në kosto dhe do të jenë të përshtatshme për të shlyer;

a) kostot e blerjes së kapacitetit dhe energjisë (përfshirë shërbimet ndihmëse përkatëse);

b) kostot e shërbimeve të transmetimit të siguruara nga TSMO-ja;

c) shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes së shpërndarjes;

d) investimet e shpërndarjes dhe kthimet e arsyeshme të tyre.

Flukset e fondeve që përfshijnë këto dhe pjesëmarrës të tjerë të tregut janë treguar në shtojcën D.

7. Operimet e shpërndarjes

DDC-ja do të bëjë propozime lidhur me tarifat e furnizimit dhe të shpërndarjes në mënyrë që DDC-ja të ketë të njëjtën tarifë furnizimi dhe shpërndarje. Kjo do të rezultojë në atë që çdo klient tarifor brenda të njëjtës klasë klientësh në të gjithë vendin të paguajë të njëjtën tarifë uniforme. Ky është një synim kryesor i QSH-së për të bërë zhvillim zonal të barabartë.

DDC-ja, që zotëron sistemet e shpërndarjes që lidhin klientët e kualifikuar me sistemin e transmetimit, do t'i sigurojë shërbim shpërndarje klientëve të saj të kualifikuar sipas sistemit të tarifave të përdorimit të shpërndarjes të miratuar nga ERE. DDC-ja do të përdorë të njëjtën metodologji për të llogaritur sistemin e tarifave të përdorimit të shpërndarjes, por do të bëjnë propozime të veçanta për sistemin e tarifave të përdorimit të shpërndarjes. Prandaj DDC-ja mund të ketë një sistem të ndryshëm të tarifave të përdorimit të shpërndarjes.

8. Rregullatori i pavarur (ERE)

Ligji nr.9072, për sektorin e energjisë elektrike, që hyri në fuqi në gusht 2003, autorizon ngritjen e një rregullatori të pavarur (ERE) për të ushtruar autoritet të gjerë rregullator në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese. Funksionimi i pavarur dhe në përputhje me ligjin për sektorin e energjisë elektrike, do të përmbushë kërkesat e direktivës së BE-së 2003/54 që parashikojnë për të tilla autoritete të jenë të autorizuar që:

a) të japë, të modifikojë dhe të revokojë licencat e pjesëmarrësve në sektorin e energjisë elektrike, përfshirë eksportuesit dhe importuesit;

b) të shqyrtojë dhe të miratojë tarifat e shitjes me shumicë dhe pakicë;

c) të shqyrtojë programet e investimit të ndërmarrjeve sipas standardit me koston më të ulët;

d) t'i rekomandojë QSH-së një model tregu të energjisë elektrike dhe të adoptojë rregulla tregu, një kod shpërndarjeje dhe një kod rrjeti për të vendosur një treg funksionues, si dhe të rregullojë kushtet e aksesit sipas modelit të adoptuar të tregut;

e) të hetojë çështje brenda autoritetit të vet si rregullator;

f) të vendosë sanksione për mospërmbushjen e vendimeve të ERE-s dhe kushteve të licencave.

Pas adoptimit nga QSH-ja te TMM-ja, ERE duhet të procedojë me adoptimin e rregullave specifike të tregut, të një kodi shpërndarjeje dhe një kodi rrjeti (për t'u përgatitur nga pjesëmarrësit e tregut) për të rregulluar hyrjen dhe për të përcaktuar më specifikisht rolet, përgjegjësitë dhe marrëdhëniet e pjesëmarrësve të tregut.

Për shembull, lidhja mes klientit të kualifikuar (KK) dhe DDC-së duhet trajtuar në mënyrë specifike në rregullat e tregut, që do të miratohen nga ERE. Megjithatë, është e rëndësishme të vihet në dukje se çmimi i pothuaj gjithë energjisë elektrike nga sistemi ekzistues hidroenergjetik do të rregullohet dhe rezervohet pothuajse tërësisht për përfitimin e klientëve tariforë shqiptarë. Një KK që zgjedh për të blerë energji elektrike si klient jotarifor nuk lejohet të ketë përsëri akses në hidroenergji nëpërmjet blerjes së energjisë elektrike nga PGC-ja ose DDC-ja. Nëse KK-ja largohet nga sistemi dhe merr energji nga një IPP ose furnizues i jashtëm, nuk do të jetë më klient tarifor që i lejohen përfitimet e hidroenergjisë me kosto të ulët. Duke zgjedhur të shkojë në treg, KK-ja merr riskun e tregut që shoqëron burimin e tij të ri të furnizimit. Rregullat e tregut duhen bërë me kujdes për të shmangur që këto risqe t'u kalohen klientëve tariforë. Njëkohësisht, rregullat e tregut mund të sigurojnë mekanizmat e duhur të tarifave për klientin e kualifikuar që largohet, për të shmangur këto risqe. Për shembull, mund të përgatitet një tarifë "stand-by". Sipas kësaj tarife, DDC-ja mund të bjerë dakord të sigurojë shërbim në rast të disa paafësive të përcaktuara nga furnizuesi i KK për sigurimin e shërbimit. KK-ja nuk do të lejohet të largohet e të kthehet sipas dëshirës nga shërbimi i DDC-së për shkak të ndryshimeve të çmimit. Rregullat e tregut duhet të përcaktojnë qartë rrethanat dhe pagesat për rikthim të një KK-je si klient tarifor dhe duhen planifikuar për të mbrojtur klientët tariforë nga kostot e rritura të shkaktuara nga ky rikthim.

Një çështje tjetër që duhet trajtuar në kodin e rrjetit dhe rregullat e tregut është çështja e prioritetit të transmetimit ose menaxhimit të bllokimit kur linjat e transmetimit janë të kufizuara dhe nuk mund t'i përballojnë kërkesat totale të klientëve tariforë dhe klientëve të kualifikuar. Rregullat e tregut duhet të përcaktojnë se si do të ndahet mungesa mes klientëve tariforë dhe klientëve të kualifikuar në mënyrë që të zbatohet nga TSMO-ja. Hartimi i këtyre rregullave duhet të udhëhiqet nga parimet e aksesit të hapur jodiskriminues, me qëllim që të plotësojnë kërkesat e BE-së për akses të hapur. Në hartimin e këtyre rregullave duhet kërkuar kontributi i të gjitha palëve të interesuara.

Vetë prodhuesit që plotësojnë, tërësisht ose pjesërisht, kërkesat e tyre për energji elektrike, të cilët mbeten të lidhur me sistemin mund të kenë tepriçë të energjisë elektrike në disa periudha. Kur ekziston një kapacitet më i madh dispeçerues pas ndërtimit të qendrës së re dispeçer, rregullat e tregut dhe të kodit të rrjetit do të sigurojnë akses në rrjet për këtë tepriçë dhe ERE do të caktojë tarifa për blerjen e kësaj energjie që krijon përfitim për konsumatorin. Këto tarifa duhet të bazohen në kosto dhe të reflektojnë momentet e kohës së përdorimit. Nëse, për shembull, vetë prodhuesi shet energji jashtë orëve pik, tarifa duhet të jetë një tarifë afatshkurtër energjie, e cila merr parasysh koston e gjenerim/transmetim/shpërndarjes së bazës. Nëse vetë prodhuesi blen energji elektrike në kohën e pikut të DDC-ve, duhet imponuar një pagesë kapaciteti për të shmangur penalizimin e klientëve tariforë. Nëse vetëprodhuesi është "jashtë sistemit" pjesën më të madhe të kohës, por dëshiron të përdorë sistemin si rezervë të njësisë vetëprodhuese në rast mirëmbajtjeje ose defekti, rregullat e tregut duhet të specifikojnë një tarifë "stand by" të ngjashme me atë të sugjeruar për IPP-të, e cila duhet të miratohet nga ERE.

9. Marrëveshjet për blerjen e energjisë elektrike

QSH-ja ka shfaqur arsye politike se pse dëshiron të inkurajojë investimet private në centrale të gjenerimit për të plotësuar kërkesat për energji të Shqipërisë, veçanërisht kur këto centrale u shërbejnë objektivave të tjera të rëndësishme kombëtare, si qëndrueshmëria e furnizimit ose diversiteti i lëndës djegëse. Investitorët në këto centrale kërkojnë shpesh PPA afatgjatë për të gjithë ose një pjesë të prodhimit të centralit për të siguruar të ardhura për pagesën e investimeve dhe interesave përkatëse. Nga ana tjetër, nëse PPA-ja nënshkruhet për të gjitha nevojat e parashikuara për kapacitete shtesë, që mund të kërkojnë në treg, atëherë ka vend për zhvillimin e tregut. Për shembull, nëse vendi kërkon përafërsisht 750 MW me shumë kapacitete gjeneruese për të mbuluar nevojat deri në vitin 2015, atëherë se PPA-të e nënshkruara nuk duhet të arrijnë më shumë se 350 deri 400 MW. Pa një kufizim të tillë do të kishte një efekt serioz vonese në zhvillimin e tregut. Kjo është e domosdoshme të merret parasysh, sepse bëhet fjalë për një ekuilibër të arsyeshëm në

portofolin e burimeve për të plotësuar kërkesat e vendit për energji. Kontratat PPA që kanë të bëjnë me luhatjen në çmimet e lëndës djegëse dhe në këmbimin valutor, duhen kufizuar sa më shumë që të jetë e mundur. Për më tepër, me qëllim që të maksimizojë investimet private në vend, ndërsa kufizon efektet shmangëse të tregut, PPA-ja është mirë të angazhohet në blerjen vetëm të një pjese të prodhimit të centralit, ndërsa pjesa tjetër vihet në dispozicion brenda dhe jashtë vendit me çmimet e tregut. Çdo sasi e disponueshme me çmim tregu në vend do të kontribuonte për zhvillimin e tregut.

10. Procesi i likuidimeve


Shëndeti financiar i TSMO-së dhe besimi në menaxhimin e procesit të likuidimeve nga TSMO-ja është absolutisht kritik për suksesin e MTT-së ose çdo modeli tregu. Detajet e procesit të likuidimeve do të specifikohen në protokollin e likuidimeve të kodit të rrjetit të rregullave të tregut të miratuara nga ERE. Fondet e likuidimit duhet të sigurohen nga shmangiet. Procesi duhet planifikuar që të funksionojë në mënyrë transparente, të mirëpresë përdorimin e kontratave dypalëshe dhe të lehtësojë përmirësimin e nivelit të arkëtimeve. Për t'u dhënë fillimisht pjesëmarrësve potencialë të REM-it besimin tek procesi duhet të sigurohen garanci mbështetëse nga Qeveria shqiptare ose komuniteti i donatorëve ndërkombëtarë. Për të siguruar integritetin e procesit duhen kryer, minimumi, auditime të rregullta.

Procesi i likuidimeve i propozuar për MTT-në është i thjeshtë, transparent dhe minimizon potencialin për shmangie të fondeve. Materiali konceptual reflekton përpjekjet për të minimizuar riskun e paaftësisë financiare duke i dhënë në këtë mënyrë shitësit në treg siguri të lartë për pagesat. Së pari, lidhjet kontraktuale mes TSMO-ve, DDC-ve dhe shitësve të energjisë elektrike janë përcaktuar jo vetëm nga marrëveshja për blerjen e energjisë elektrike mes TSMO-së dhe shitësit, por gjithashtu nga një marrëveshje për kontrata shërbimesh mes TSMO-së dhe DDC-së. Sipas marrëveshjes për kontrata shërbimesh, TSMO-ja bie dakord të blejë energji elektrike në emër të DDC-ve. Nga ana tjetër DDC-ja bie dakord të kompensojë TSMO-në për kryerjen e këtyre shërbimeve dhe t'i paguajë direkt shitësit kostot e energjisë siç jepet në raportet e DDC-ve për TSMO-në. Rregullat e tregut do të kërkojnë që DDC-ja ta paguajë shitësin direkt, por nëse sipas ligjit shqiptar është e nevojshme një marrëdhënie direkte kontraktuale me shitësin për të krijuar një detyrim pagimi për shitësin, DDC-ja do të bëhet pjesë e marrëveshjes së blerjes së TSMO-së me shitësin, me qëllim të afirmimit të detyrimit dhe angazhimit të tyre për të kryer pagesën direkt te shitësi. Shitësi do të ketë rritur besimin për pagesën sepse: (1) pala dërguese (DDC) është afër burimit të fondeve për pagesë (Klientët tariforë), (2) eliminohet një hap i panevojshëm që përfshin transferimin e *cash*-it duke minimizuar në këtë mënyrë shanset për shmangie fondesh dhe (3) marrëveshja për shërbimet kontraktuale është miratuar nga ERE. Një fond barazues është në përputhje me MTT-në dhe procesin e likuidimeve të përshkruar më lart, me kusht që të përfshihet mbrojtja e duhur dhe e detyrueshme kundër korrupsionit dhe shmangies, për të ruajtur besimin e shitësit te procesi i likuidimeve, si dhe për të shmangur vonesat në përmbytjen në kohë të çdo pagese të skeduar.

SHTOJCA A


STRUKTURA TRANZITORE E TREGUT

Marrdheniet Kontraktuale Ndermjet Pjesmarresve



SHTOJCA B


STRUKTURA TRANZITORE E TREGUT Dispeçerimi & Kontrolli i Sistemit



SHTOJCA C

STRUKTURA TRANZITORE E TREGUT


Fluksi i Energjise Elektrike



SHTOJCA D

STRUKTURA TRANZITORE E TREGUT

Likuidimet - Fluksi i Fondeve



*Shenim 1: Pagesa per Kontratat Vjetore te Furnizimit te Rregulluar me Energji Elektrike;
Pagesa per Marrveshjet e Furnizimit me Sherbime Ndihmese; Pagesa per Energji Elektrike the Sherbime Ndihmese te Blera Jashte Kontratave Vjetore*

Shenim 2: Pagesa per Marrveshjet e Furnizimit me Sherbime Ndihmese

Shenim 3: Pagesa per Tarifat e Perdoritimit te Sistemit te Shperndarjes

VENDIM
Nr.540, datë 12.8.2004

PËR RISTRUKTURIMIN E KESH SH.A.-SË DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.171, DATË 19.4.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE TË SEKTORIT ELEKTROENERGJETIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 12 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfundimin brenda datës 31.12.2004 të komercializimit të prodhimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a.

2. Realizimin e korporatizimit të shoqërisë së prodhimit dhe të asaj të shpërndarjes nga KESH sh.a., bazuar në studimin për rristrukturimin e kësaj shoqërie, brenda datës 30.6.2005.

3. Ndryshimin në dokumentin e politikës së sektorit elektroenergjetik të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.171, datë 19.4.2002 të Këshillit të Ministrave, si më poshtë vijon:

Detyrat e parashikuara në nëndarjen KESH, shkronja “B”, pikat (iii) dhe (iv) të kapitullit IV “Pikësytymet kryesore për veprim”, hiqen dhe shtohen në shkronjën “C”, përkatësisht me pikat (v) e (vi) të po këtij kapitulli, si detyra të KESH sh.a.-së, me këtë përmbajtje:

“(v) Të korporatizojë ndërmarrjet e ndara;

(vi) Të sigurojë asistencë menaxhimi për kompanitë e shpërndarjes dhe të gjenerimit, nëse është marrë një vendim për këtë qëllim, në vitin e parë.”.

4. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.541, datë 12.8.2004

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË KORESË, PËR HUATË NGA FONDI I BASHKËPUNIMIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË KORESË, PËR NJË HUA NGA FONDI I BASHKËPUNIMIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Koresë, për huatë nga fondi i bashkëpunimit për zhvillim ekonomik dhe të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Koresë, për një hua nga fondi i bashkëpunimit për zhvillim ekonomik.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE

NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË KORESË PËR HUATË NGA FONDI I BASHKËPUNIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Koresë (më poshtë referuar si “Palët”), nisur nga dëshira për të mbështetur zhvillimin ekonomik të Republikës së Shqipërisë dhe për të nxitur bashkëpunimin ekonomik midis dy vendeve, bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Qeveria e Republikës së Koresë, në bazë të rregullave dhe të ligjeve të saj, do t’i japë hua Qeverisë së Republikës të Shqipërisë (më poshtë referuar si “Huamarrësi”) nga fondi i bashkëpunimit për zhvillimin ekonomik (më poshtë referuar si “EDCF”) për zbatimin e projekteve, pasi të jetë rënë dakord ndërmjet “Palëve” (më poshtë referuar si “Projekti”).

Neni 2

Palët, për zbatimin e Marrëveshjes do të përfundojnë marrëveshje rregulluese të veçanta (më poshtë referuar si “Marrëveshje Rregulluese”), ku do të specifikohet shuma, terminologjia dhe kushtet e huasë nga EDCF (më poshtë referuar “Huaaja”).

Neni 3

1. Huaaja do të bëhet e vlefshme në bazë të një marrëveshjeje huaje (më poshtë referuar si “Marrëveshja e Huasë”) të arritur ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës së Export-Importit të Koresë (më poshtë referuar si “Banka”), agjencia qeveritare për EDCF-në.

2. Në rast se Huamarrësi nuk është Qeveria e Republikës së Shqipërisë, një garanci për huanë nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t’i dorëzohet Bankës.

Neni 4

Shuma e huasë do të përdoret për të mbuluar pagesat që do të bëhen nga agjencitë ekzekutive të projektit të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, për firmat furnizuese, kontraktorët dhe/ose konsulentët e vendeve të përzgjedhura, në bazë të kontratave që mund të lidhen ndërmjet tyre për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për zbatimin e projektit.

Neni 5

Në lidhje me transportin dhe sigurimin e transportit detar të mallrave të prokuruar nën këtë hua, Qeveria e Republikës së Shqipërisë nuk do të vërë kufizime që mund të pengojnë konkurrencën e ndershme e të lirë ndërmjet kompanive të transportit dhe të sigurimit të transportit të të dy vendeve.

Neni 6

Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të ndërmarrë masa të nevojshme për të lehtësuar aktivitetet e personave me kombësi koreane të përfshirë në këtë projekt e do t’i ndihmojë ata për të përfutur shërbime të tilla, si dhe komoditetet që kërkohen për të kryer detyrat e tyre në Republikën e Shqipërisë.

Neni 7

Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të përjashtojë Bankën nga ndonjë vënie takse apo detyrim fiskal në lidhje me huanë dhe interesin rrjedhës lidhur me të.

Neni 8

Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar që lehtësirat e krijuara në lidhje me huanë, të mbahen dhe të përdoren ekskluzivisht për qëllimin e përshkruar në këtë Marrëveshje.

Neni 9

Palët Kontraktuese do të konsultohen, me kërkesën e secilës palë, me njëra-tjetrën, për çështjet që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, dhe në përputhje me ligjet dhe rregullat respektive, të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për përdorimin në mënyrën e duhur dhe efektive të huasë.

Neni 10

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit në të cilën palët njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore të tyre.

2. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë prej dhjetë (10) vjetësh dhe do të vazhdojë pa kufi, deri sa ndonjëra nga Palët Kontraktuese do të njoftojë tjetrën me shkrim, gjashtë (6) muaj përpara, se ka për qëllim ta përfundojnë atë.

3. Modifikimi ose përfundimi i kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e marrëveshjeve rregulluese dhe marrëveshjeve të huasë të përfunduara në këtë Marrëveshje gjatë periudhës së vlefshmërisë së tyre respektive.

Si provë e nevojshme, nënshkruesit do të duhet të jenë të autorizuar nga qeveritë respektive për të nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 26 maj 2004 në gjuhën shqipe, koreane dhe angleze, të gjitha tekstet do të jenë autentikisht të barabarta. Në rast divergjence për mënyrën e interpretimit, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

MARRËVESHJE

NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË KORESË PËR HUA NGA FONDI I BASHKËPUNIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Koresë, në përputhje me Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Koresë lidhur me huatë nga fondi i bashkëpunimit për zhvillim ekonomik (më poshtë referuar si “EDCF”), firmosur në Tiranë, datë 26 maj 2004, bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës së Koresë i ka dhënë mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë të përfitojë një hua (më poshtë referuar si “Hua”) nga Banka e Eksport-Importit të Koresë (më poshtë referuar si “Banka”), agjencia qeveritare për EDCF, për zbatimin e projektit të elektrifikimit të zonës rurale (më poshtë referuar si “Projekti”).

2. Huamarrës do të jetë Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

3. Shuma e huasë do të emërohet në won korean. Shuma e huasë nuk do të kalojë barasvlefshmërinë prej njëzet e pesë milionë (25 000 000) USD dhe do të fiksohet në përputhje me kushtet përkatëse të marrëveshjes së huasë, e cila do të mbyllet ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës (më poshtë referuar si "Marrëveshja e Huasë").

Neni 2

Termat dhe kushtet e huasë, si dhe procedurat për përdorimin e saj, do të vendosen nga Marrëveshja e huasë, e cila do të përmbajë parimet si vijojnë:

1. Periudha e shlyerjes do të jetë tridhjetë (30) vjet duke përfshirë një periudhë të lirë prej dhjetë (10) vjetësh.

2. Përqindja e interesit do të jetë dy presje pesë për qind (2.5%) në vit.

3. Periudha e disbursimit do të kryhet për 40 muaj nga data e bërjes efektive të Marrëveshjes së huasë ose një periudhë tjetër për të cilën vendosin Huamarrësi dhe Banka.

4. Një pagesë e shërbimit prej 0.1% të shumës të çdo disbursimi në rast të procedurave të pagimit direkt ose të shumës të specifikuar në letrën e angazhimit në rastin e procedurës së angazhimit, do të mbahet nga Banka. Të gjitha pagesat bankare dhe/ose kostot për shërbimet e kryera nga bankat në lidhje me disbursimet në procedim të huasë, ripagesa e shumës kryesore ose pagesa e interesit që i paguhen Bankës sipas Marrëveshjes së huasë do të jenë subjekt i një marrëveshjeje rregullimi bankare, e cila do të nënshkruhet midis bankave përkatëse të dy vendeve.

5. Në rast se Huamarrësi do të dështojë në kryerjen e pagesës së principalit ose të ndonjë pjese të principalit të huasë, ose të ndonjë shume tjetër si detyrim nën Marrëveshjen e huasë, shuma e mospaguar do të pësojë një detyrim shtesë prej 2% në vit, përmbi përqindjen e shkallës së interesit.

Neni 3

1. Vendet e përzgjedhura për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për projektin do të jenë Republika e Koresë dhe Republika e Shqipërisë. Prokurimi për projektin nga ndonjë shtet i tretë mund të lejohet me miratimin paraprak të Bankës për deri 21.8% të shumës së huasë për projektin, në qoftë se është e pamundur ose joekonomike për të blerë mallra dhe shërbime nga shtetet e përzgjedhura.

2. Furnizuesit e mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për zbatimin e projektit do të përzgjidhen nëpërmjet tenderit të kufizuar ndërmjet shoqërive koreane ose duke kontraktuar direkt me një kompani koreane.

3. Kontrata e prokurimit do të mbyllet brenda 18 muajve pas datës efektive të Marrëveshjes së huasë.

4. Detajet e metodave dhe procedurave të prokurimit do të administrohen nga Marrëveshja e huasë.

Neni 4

Në rast se fondet e vëna në dispozicion nga livrimi i huasë janë të mjaftueshme për zbatimin e plotë të projektit, Huamarrësi do të bëjë menjëherë ndërhyrjen për të siguruar ato fonde që nevojiten.

Neni 5

Huaja do të disbursohet nga Banka për Huamarrësin ose për furnizuesin në emër të Huamarrësit në bazë të progresit të projektit, deri në shumën e huasë, dhe brenda periudhës së disbursimit të specifikuar në Marrëveshjen e huasë dhe sipas procedurave të disbursimit të përcaktuara në Marrëveshjen e huasë.

Neni 6

Termat dhe kushtet e tjera për t'u specifikuar në Marrëveshjen e huasë do të përcaktohen nëpërmjet bisedimeve ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës.

Neni 7

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nga Palët Kontraktuese, që njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore të tyre për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes dhe do të mbetet efektive, veç nëse do të bihet dakord ndryshe nga Palët Kontraktuese, derisa Huamarrësi të kryejë të gjitha detyrimet sipas Marrëveshjes së huasë.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit do të duhet të jenë të autorizuar nga qeveritë respektive për të nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 26 maj 2004 në gjuhën shqipe, koreane dhe angleze, të gjitha tekstet do të jenë autentikisht të barabarta. Në rast divergjence për mënyrën e interpretimit, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

VENDIM

Nr.542, datë 12.8.2004

PËR STATUSIN E USHTARAKUT ME GRADË MADHORE TË FORCAVE TË ARMATOSURA PAS DALJES NË LIRIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 22 të ligjit nr.9171, datë 22.1.2004 "Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dorëzimi i detyrës së ushtarakut me gradë madhore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në çastin e daljes në lirim, të bëhet me ceremoni ushtarake, sipas rregullores së ceremonialit ushtarak.

2. Ushtaraku me gradë madhore përfiton, në çastin e daljes në lirim, një pagesë të menjëhershme, të barabartë me aq paga sa ka vite shërbimi në gradat madhore. Nëse vitet e shërbimit nuk janë të plota, shpërblimi të llogaritet në përpjestim me muajt që ka shërbyer.

3. Për efektet e këtij vendimi shpërblimi të llogaritet mbi pagën e fundit që ka pasur ish-ushtaraku me gradë madhore.

4. Kur paraqiten rrethana, që rrezikojnë jetën apo pronën e ish-ushtarakut me gradë madhore, në bazë të kërkesës së tij, i sigurohet ruajtja, për aq kohë sa ekziston ky rrezik.

5. Efektivi që merret me ruajtjen dhe sigurimin e ish-ushtarakut me gradë madhore, është pjesë e efektivit të batalionit të Policisë Ushtarake.

6. Në rastet e zhvillimit të ngjarjeve përkujtimore apo të ceremonive ushtarake, ftohet të marrë pjesë ish-ushtaraku me gradë madhore, i cili ka vendin e vet, të përcaktuar sipas rregullores së ceremonialit ushtarak. Ministria e Mbrojtjes përballon shpenzimet e nevojshme për pjesëmarrjen e tij në këto ceremoni.

7. Të drejtat e përcaktuara në këtë vendim përfitohen kur kohëzgjatja e qëndrimit në detyrë është jo më pak se një vit.

8. Në rastet e daljes në lirim sipas shkronjave "b" e "d" të pikës 1 të nenit 25 të ligjit nr.9171, datë 22.1.2004 "Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", ish-ushtaraku me gradë madhore nuk përfiton sipas këtij vendimi.

9. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimin i këtij vendimi, të planifikohen dhe të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

10. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2005.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.543, datë 12.8.2004

PËR RITJEN E PAGESËS KALIMTARE TË USHTARAKUT NË REZERVË (LIRIM)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 18 e 21 të ligji nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rritjen në masën 8 për qind të pagesës kalimtare të ushtarakut në rezervë (lirim), të caktuar deri më datë 1.7.2004, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Këtë rritje e përfiton ushtaraku i nxjerrë në rezervë (lirim) nga strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ të Shtetit.

2. Efektet financiare të përballohen nga Buxheti i Shtetit i vitit 2004, miratuar, përkatësisht, për Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Rendit Publik dhe Shërbimin Informativ të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Rendit Publik dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet financiare nga data 1.7.2004.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.544, datë 12.8.2004

PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS DHE TË DOKUMENTIT TË LEGALIZIMIT TË SHITESAVE NË NDËRTIME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 5, pika 2 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004 “Për legalizimin e shtesave në ndërtime”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Subjekti juridik, që ka kryer ndërtim me sipërfaqe më të madhe se projekti i miratuar me vendim të KRRT-së së njësisë së qeverisjes vendore dhe që ka depozituar e protokolluar kërkesën

për legalizimin e shtesës brenda afateve të përcaktuara në paragrafin e parë të nenit 6 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004 “Për legalizimin e shtesave në ndërtime”, duhet të plotësojë formularin A “Kërkesa teknike”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Njësia e urbanistikës e njësisë së qeverisjes vendore e pajis subjektin me këtë formular.

2. Subjekti juridik plotëson dhe depoziton në njësinë e urbanistikës formularin A dhe dokumentacionin e përcakuar në nenin 2 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004 “Për legalizimin e shtesave në ndërtime”, brenda afatit të caktuar në pikën 2 të nenit 6 të po këtij ligji.

3. Kur njësia e urbanistikës vëren se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e legalizimit dhe se subjekti i ka shlyer të gjitha detyrimet e përcaktuara me ligj, vendos ta pajisë atë me dokumentacionin e nevojshëm, si më poshtë vijon:

a) Me leje të re ndërtimi për të gjithë objektin, përfshirë edhe sipërfaqen jashtë lejes së miratuar, për ndërtimet e përfshira në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004.

Vlerësohen ndërtimet e papërfunduara, ndërtimet për të cilat procesverbali i përfundimit të karabinasë është depozituar deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit të sipërpërmendur.

b) Me dokumentin e legalizimit shtesë, sipas formularit B “Legalizim shtesë”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për ndërtime e përfshira në pikën 2 të nenit 5 të ligjit nr.9209, datë 23.3.2004.

Vlerësohen ndërtimet e përfunduara, ndërtimet për të cilat subjekti juridik ka depozituar, në përputhje me nenin 13 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, pranë njësisë së urbanistikës së njësisë së qeverisjes vendore, kërkesën për marrjen e lejes së shfrytëzimit.

4. Ngarkohen Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

KËRKESA TEKNIKE

PËR LEGALIZIMIN E SHITESËS

MBI LEJEN E NDËRTIMIT MIRATUAR ME VENDIMIN E KRRT NR. __ DATË __/__/__

OBJEKTI _____

NJËSISË SE URBANISTIKËS SË NJËSISË VENDORE _____

Subjekti ndërtues _____

numri i licensës _____ data _____

Adresa e sheshit të objekti _____

Gjendja faktike është përfunduar ... ☐ / nuk është përfunduar ... ☐ [plotëso me kryq]

Prona shtesë [nëse ka] është publike ... ☐ / private ... ☐ [plotëso me kryq]

Të dhënat sipas lejes së miratuar

Sipërfaqja e sheshit ... [m²];

Sipërfaqja e ndërtimit ... [m²];

Vëllimi i objektit ... [m³];

Lartësia e Përgjithshme ... [m];

Nr. kateve mbi tokë ... / nën tokë ...

Të dhënat sipas gjendjes faktike

Sipërfaqja e sheshit ... [m²];

Sipërfaqja e ndërtimit ... [m²];

Vëllimi i objektit ... [m³];

Lartësia e Përgjithshme ... [m];

Numri i kateve mbi tokë ... / nën tokë ...

Për të gjitha ndryshimet e mësipërme si arkitektonike dhe konstruktive të objektit, autorët e projektit janë dakort:

Arkitekt _____

Emri

Mbiemri

A- _____

numri i licensës

data

nënshkrimi

Konstruktor _____

Emri

Mbiemri

K- _____

numri i licensës

data

nënshkrimi

Bashkë me këtë kërkesë parqes:

1. Vendimet e K.R.R.T. për lejen e sheshit dhe lejen e ndërtimit.
2. Projektin e plotë teknik të objektit ku të evidentohen ndryshimet.
3. Formularin 3/1 të rifreskuar, të plotësuar sipas kërkesës së ligjit.
4. Të dhënat e studimeve gjeologo-inxhinierike të rifreskuar.
5. Të dhënat e studimeve inxhiniero-sizmiologjike për objektet të marra nga Instituti i Sizmiologjisë.
6. Dokumentat e pronësive nga Zyra e hipotekës të rifreskuara.
7. Kontrata e rifreskuar me pronarët e truallit dhe aktmarrveshjet me pronarët kufitarë të cënuar.

Përsa parashtroj në kërkesën time deklaroj se janë të vërteta dhe origjinale

Mendimi i zyrës së Urbanistikës sipas përkatësisë _____

DREJTUESI LIGJOR I SUBJEKTIT NDËRTUES

(.....)

Data .../.../200...



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

NJËSIA VENDORE _____
NJËSIA E URBANISTIKËS

LEGALIZIM SHITESË

NR. ____ DATË ____/____/200__

MIRATONET ☐

NUK MIRATONET ☐

OBJEKTI _____

SUBJEKTIT _____ ME NR. LICENSE _____

MBI LEJEN E NDËRTIMIT MIRATUAR ME VENDIMIN E KRYT NR. ____ DATË ____/____/____

ME SPECIFIKIMET SI MË POSHTË:

1. Sipërfaqja e sheshit që legalizohet [m²];
2. Sipërfaqja ndërtimit që legalizohet [m²];
3. Sipërfaqja totale e ndërtimit që legalizohet [m²];
4. Volumi i ndërtimit që legalizohet [m³];
5. Lartësia e përgjithshme e objektit [m];
6. Numri i kateve shtesë që legalizohen (mbi tokë) (nën tokë)
7. Lloji i mbulesës
8. Distanca e volumit nga aksi i rrugës [m]; Nga trotuari [m];
9. Distanca e volumit nga kufijtë e pronës:

Veriu [m];

Lindja [m];

Jugu [m];

Perëndimi [m];

PËRGJEGJËSI I URBANISTIKËS

KRYETARI I NJËSISË VENDORE

(.....)

(.....)

Data/...../200...

VENDIM
Nr.545, datë 12.8.2004

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.722, DATË 19.11.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË URBANISTIKËS”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, dhe të nenit 41 të ligjit nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit e të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren e urbanistikës, miratuar me vendimin nr.722, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 46, pas shkronjës “j” shtohet shkronja “k”, me këtë përmbajtje:
“k) Normat teknike dhe rregullat për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.”.
 2. Në fund të shkronjës “b” të pikës 48 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:
“Projekti teknik i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit.”.
 3. Në fund të pikës 116 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:
“Kërkesat për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.547, datë 12.8.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.485, DATË 16.7.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR TRANSFERIMIN E FONDEVE BUXHETORE BASHKISË SË
ELBASANIT, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE ADMINISTRATIVE TË QENDRËS
SOCIALE “BALASHE””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 14 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004” dhe të nenit 13 të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.485, datë 16.7.2004 të Këshillit të Ministrave, shifra “...648 350 (gjashtëqind e dyzet e tetë mijë e treqind e pesëdhjetë) lekësh...”, zëvendësohet me “... 6 483 000 (gjashtë milionë e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë) lekësh...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.548, datë 12.8.2004

**PËR NJË NDRYSHIM LIMITI NË FONDET E KUSHTËZUARA, MIRATUAR NË
BUXHETIN E VITIT 2004, PËR MINISTRINË E KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
DHE MINISTRINË E MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe e nenit 14 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, t’i shtohet fondi i kushtëzuar me shumën 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, në zërat si më poshtë vijon:
 - Zëri “Shpenzime operative” 4 500 000 (katër milionë e pesëqind mijë) lekë;
 - Zëri “Paga e shpërblime të tjera” 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.
 2. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, t’i pakësohet fondi i kushtëzuar me shumën 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, zëri “Paga e shpërblime të tjera”.
 3. Ngarkohen Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.550, datë 12.8.2004

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.329, DATË 12.7.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PROCEDURAT E TENDERIT PËR ZGJEDHJEN E
INVESTITORËVE STRATEGJIKË DHE PËR TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TË
ZOTËRUARA NGA SHTETI NË SHOQËRITË TREGTARE TË SEKTORËVE ME
RËNDËSI TË VEÇANTË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e kapitullit III të vendimit nr.329, datë 12.7.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshohet dhe të riformulohet si më poshtë vijon:
 - “1. Një njoftim publik botohet në tri gazeta me qarkullim ndërkombëtar. Koha dhe mënyra e publikimit përcaktohen rast pas rasti nga komiteti i konsulencës dhe i transparencës për privatizimin e sektorëve me rëndësi të veçantë të ekonomisë, me asistencën e shoqërisë konsulente. Njoftimi afishohet në zonën pranë selisë së shoqërisë tregtare që do të privatizohet, si dhe dërgohet me anë të letrave, telefaksit dhe publikohet në internet.”.
 2. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.551, datë 12.8.2004

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.334, DATË 29.5.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR PIRAJ-
KTHESA VAU I DEJËS, PJESË E SUPERSTRADËS LEZHË-SHKODËR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.334, datë 29.5.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 3 të shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Pronarët e pasurive të paluajtshme shtesë, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, e cila paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqe 5 223 m² tokë/arë, tokë-pyjore-kullotë 15 970 m², tri ndërtesa banimi me vlerë 9 054 108 (nëntë milionë e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e tetë) lekë, kultura bujqësore me vlerë 83 568 (tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë, dru frutorë me vlerë 4 765 000 (katër milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë, me vlerë të përgjithshme 23 394 376 (njëzet e tre milionë e treqind e nëntëdhjetë e katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë.”.

2. Pas pikës 4 të shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 380 528 (treqind e tetëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet e tetë) lekë.”.

3. Pas pikës 5 të shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1. Fondi prej 23 774 904 (njëzet e tre milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e katër) lekësh, për kompensimin e pronarëve të shpronësuar dhe për shpenzimet procedurale, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2004, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.”.

4. Pas pikës 6 të shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Shpronësimi të fillojë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi dhe të përfundojë brenda datës 30.9.2004.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA JURIDIKE
QARKU: LEZHE dhe SHKODER

Lista e pronareve qe shpronesohen(shfese) per shkak te ndertimit te segmentit rrugor Lezhe - Shkoder seksioni i katert Piraj - Kthesa Vau i Dejes

Lloji i pasurise se paltajishme: Toke are - Pemtores, Pyje - Kullote, Nderfese,kult.buqj. dhe dru frutore Nr. 1-60

Nr.	Proprari		Nr. i pas.	VKM m.334	Sip. are/Pem. m2	Cmimi lek/m2	Vlera ne lek	Dif. Sip. Pyje-kult. m2	Cmimi lek/m2	Vlera ne lek	Ndet. sip. m2	Cmimi lek/m2	Vlera ne lek	Kult.buqj. Leke	Vlera dru-frut. leke	Totali ne leke
	Emri	Atesia	Mbrentri													
1	Frok	Gjon	Ndreca	133/15	510										506000	506000
2	Lazer	Luk	Marku	132/13	2469	190	171000							3040		174040
3	Ejell	Gjon	Shijefni	120/4	334	90	81000							1440		82440
4	Jak	Dode	Rrazhani	120/5	2319	90	81000							1440		82440
5	Gani	Mustaf	Shahini	47/4	237	60	54000							960		54960
6	Shaban	Hider	Shahini	47/3	29	80	72000							1280		73280
7	Hider	Mustaf	Shahini	48/8	128	34	30600							544		31144
8	Shaban	Hider	Shahini	48/7	207	45	40500							720		41220
9	Xhevat	Daut	Shahini	48/6	266	58	52200							928		53128
10	Asllan	Zenel	Dani	42/20							156/78	24738	5788692		344000	6132692
11	Naim	Falk	Dani	1/17		646	581400							10336		591736
12	Pjeter	Ndue	Doda	5/2							156 50%amort.	1929564	1929564		205000	2134564
13	Ded	Ndue	Doda	5/3							108 50%amort.	1335852	1335852			1335852
14	Hasan	Hamz	Hamzi	1/14	1378											606600
15	Ismail	Hamz	Hamzi	1/14	1378											606600
16	Zade	Hamz	Hamzi	1/14	1378											606600
17	Bice		Zagani	425/3												252000
18	Mejteme		Zagani	425/3												252000
19	Sofije		Zagani	425/3												252000
20	Minire		Zagani	425/3												252000
21	Haziz		Gerbeti	425/3												50400
22	Fatmira		Gerbeti	425/3												50400

[illegible]

VENDIM
Nr.552, datë 12.8.2004

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.246, DATË 24.4.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR BALLDRE-
PIRAJ, PJESE E SUPERSTRADËS LEZHË-SHKODËR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.246, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 3 të shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Pronarët e pasurive të paluajtshme shtesë, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, e cila paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqe 1606 m² tokë/arë dhe për kulturë bujqësore 25 696 (njëzet e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë, me vlerë të përgjithshme 1 471 096 (një milion e katërqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.”.

2. Pas pikës 4 të shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 213 840 (dyqind e trembëdhjetë mijë e tetëqind e dyzet) lekë.”.

3. Pas pikës 5 të shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1. Fondi prej 1 684 936 (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh, për kompensimin e pronarëve të shpronësuar dhe për shpenzimet procedurale, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2004, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.”.

4. Pas pikës 6 të shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Shpronësimi të fillojë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi dhe të përfundojë brenda datës 30.9.2004.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA JURIDIKE
QARKU: LEZHË

Lista e pronarëve që shpronësohen për shkak të ndërtimit të segmentit rrugor Lezhë-Shkodër seksioni i tretë Balldre-Piraj

Nr.	Pronar			Fshati Z.K.	Nr. Pas.	Sip. Shpr. Tot.m ²	VKM Nr.246 24.4.20 03	Dif. Sip. Arë m ²	Çmimi lek/m ²	Vlera Lekë	Kult bujq. në lekë	Vlera Totale lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri										
1	Nikoll	Ndue	Nikolla	Kallmet	209/24	1145	1060	85	900	76500	1360	77860	Zonë kadastrale e peregjistruar
2	Tom	Jak	Kola		209/23	1188	969	219	900	197100	3504	200604	Zonë kadastrale e peregjistruar
3	Gjin	Jak	Kola		209/22	802	760	42	900	37800	672	38472	Zonë kadastrale e peregjistruar
4	Rrok	Mark	Skandaj	Baqel	2/3	1864	1848	16	900	14400	256	14656	
5	Sandër	Mark	Skandaj		2/2	1028	924	104	900	93600	1664	95264	
6	Mark	Dodë	Skandaj		2/1	944	924	20	900	18000	320	18320	
7	Zef	Nikoll	Suli	Gjader	79/3	1716	1584	132	900	118800	2112	120912	
8	Nikoll	Zef	Suli		79/4	794	726	68	900	61200	1088	62288	
9	Ndoc	Mark	Shtjefni	Dajç	277/1	4952	4752	200	900	180000	3200	183200	
10	Vlash	Ndoc	Shtjefni		277/5	200		200	900	180000	3200	183200	
11	Dila	Pjetër	Miloti		165/19	1978	1458	520	900	468000	8320	476320	
				Shuma		16611	15005	1606	900	144540 0	25696	1471096	

Mbyllet me numrin rendor 11 (njëmbëdhjetë)

Shpenzime procedurale lekë 213 840
Vlera totale për shpronësim lekë 1 684 936

VENDIM
Nr.553, datë 12.8 2004

**PËR PROCEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E LEJEVE TË KONCESIONIT PËR
NDËRTIMIN DHE PËRDORIMIN E RAFINERIVE, NAFTËSJELLËSVE
E GAZSJELLËSVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shoqëritë anonime për ndërtimin dhe përdorimin e rafinerive të reja, naftësjellësve ose gazsjellësve, për përpunimin, transportimin, tregtimin, importimin dhe eksportimin e naftës bruto, gazit natyror dhe nënprodukteve të tyre, të pajisen me leje koncesioni, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, me procedura të hapura, transparente dhe lehtësisht të verifikueshme, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë vendim.

2. Subjektet, që kërkojnë të pajisen me leje koncesioni përpara fillimit të ndërtimit dhe vënies në funksionim të rafinerive, naftësjellësve ose gazsjellësve, të paraqesin në Drejtorinë e Përgjithshme të Hidrokarbureve në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet një kërkesë, të shoqëruar me këto dokumente:

a) Vendimin e gjykatës për regjistrimin e personit juridik si shoqëri anonime;
b) Certifikatën e regjistrimit në zyrën e tatimeve dhe dokumentin e NIPT-it për personat juridikë;

c) Projektidenë me treguesit kryesorë teknikë, teknologjikë dhe financiarë për ndërtimin e rafinerisë, naftësjellësit ose gazsjellësit dhe të instalimeve të tjera në funksion të tyre;

ç) Skemë-idenë, genplanin dhe dokumentet e pronësisë mbi tokën apo formën e përdorimit të kësaj prone (pronësi, qira etj.), në rastin kur objekti kërkohet të ndërtohet në zona të miratuara sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.251, datë 20.4.2001, si dhe në zona të tjera të miratuara me vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave;

i. Kur rafineria, naftësjellësi ose gazsjellësi do të ndërtohet në territore në brendësi të vendit (tokë dhe det), nevojiten skemë-ideja dhe genplani i sipërfaqes ku parashikohet të ndërtohet objekti së bashku me azhurnimet paraprake teknike dhe administrative.

ii. Kur naftësjellësi ose gazsjellësi janë pjesë e tubacioneve që kalojnë transit në territorin e Republikës së Shqipërisë (në më shumë se dy vende në tokë dhe det), nevojiten skemë-ideja dhe genplani i sipërfaqes ku parashikohet të ndërtohet objekti, të shoqëruara me një skemë tërësore të gjithë shtrirjes së objektit në vendet e tjera të rajonit, së bashku me azhurnimet paraprake teknike dhe administrative, sipas situatës në terren për territorin shqiptar. Pjesë e dokumentacionit të jetë edhe praktika procedurale, që disponon subjekti për marrëveshjen ose miratimin në parim të projektit, me vendet e tjera, në territoret e të cilave parashikohet të kalojë naftësjellësi ose gazsjellësi.

d) Dokumentacionin, që vërteton përvojën në fushën e ndërtimit ose përdorimit të rafinerive, naftësjellësve ose gazsjellësve, si dhe dokumentacionin nga organet gjyqësore e nga administrata e shtetit që vërteton se nuk është penalizuar për veprimtarinë që ushtron;

dh) Dokumentin bankar që vërteton kredibilitetin financiar për mundësinë e ndërtimit të rafinerisë, naftësjellësit ose gazsjellësit referuar objektit që paraqitet në projektide.

3. Ngritjen dhe funksionimin, pranë ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, të komisionit të vlerësimit të kërkesave, me këtë përbërje:

- Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës	3 anëtarë
- Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizimit	1 anëtar
- Ministria e Ekonomisë	1 anëtar
- Ministria e Financave	1 anëtar

Kryetari i komisionit caktohet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet.

a) Komisioni i vlerësimit të kërkesave vlerëson kërkesat dhe dokumentacionin e paraqitur nga shoqëritë, sipas përcaktimit të pikës 2 të këtij vendimi.

Në rast se ka më shumë se një shoqëri, që plotëson të njëjtat kushte për dhënien e lejes së koncesionit, si kriter për përzgjedhje komisioni të përdorë vlerën e bonusit që ofron secila shoqëri në dispozicion të Buxhetit të Shtetit.

b) Mënyra e funksionimit të komisionit të vlerësimit të kërkesave përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për hidrokarburet, Ministrit të Ekonomisë, Ministrit të Financave dhe Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizimit, i cili duhet të dalë brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi.

4. Komisioni i vlerësimit të kërkesave mbledhet brenda një periudhe kohore 15 ditë-pune nga data e paraqitjes së kërkesës dhe bën verifikimin e dokumentacionit për ofertën përkatëse, si dhe të disponimit të sipërfaqes në zonën, ku kërkohet të ndërtohet rafineria, naftësjellësi ose gazsjellësi.

a) Kur, pas verifikimit, rezulton se dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria është i rregullt, komisioni pranon kërkesën dhe brenda 5 ditëve i paraqet për miratim ministrit përgjegjës për hidrokarburet autorizimin për vazhdim procedure, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Hidrokarbureve, për plotësimin e dokumentacionit teknik dhe ekonomik për objektin në zonën dhe sipërfaqen e kërkuar, si dhe për realizimin e praktikave përkatëse deri në marrjen e lejes së koncesionit.

b) Dhënia e autorizimit bëhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë vendim dhe një kopje e tij depozitohet në Këshillin e Ministrave.

c) Kur, pas verifikimit, rezulton se dokumentacioni i paraqitur nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, komisioni hedh poshtë kërkesën dhe brenda 5 ditëve i kthen subjektit dokumentacionin përkatës, së bashku me një shkresë ku argumentohet vendimi i marrë. Subjekti ka të drejtën e riaplikimit.

ç) Kur subjekti nuk është dakord me vendimin e komisionit ka të drejtën e ankimimit brenda 10 ditëve nga data e vendimit, pranë ministrit përgjegjës për hidrokarburet, vendimi i të cilit jepet brenda 10 ditëve dhe është përfundimtar.

5. Autorizimi për vazhdim procedure duhet të përmbajë:

a) Emrin e shoqërisë që paraqet kërkesën, numrin e vendimit të gjykatës dhe NIPT-in.

b) Të drejtën ekskluzive për të investuar për përgatitjen e dokumentacionit të plotë në zonën përkatëse, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për marrjen e lejes së koncesionit nga Këshilli i Ministrave.

c) Afatin kohor të vlefshmërisë së autorizimit për vazhdim procedure, brenda të cilit duhet të përfundojë përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e lejes së koncesionit deri në paraqitjen e tij në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet, për procedim të mëtejshëm.

Ky afat në çdo rast nuk mund të jetë më shumë se dy vjet.

6. Shoqëria e pajisur me autorizim për vazhdim procedure duhet të paraqesë në Drejtorinë e Përgjithshme të Hidrokarbureve në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet, brenda afatit të përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi, dokumentacionin e plotë zyrtar, për marrjen e lejes së koncesionit.

Ky dokumentacion duhet të përmbajë:

a) Studimin urbanistik dhe sheshin e ndërtimit të miratuar nga organi përgjegjës i përcaktuar me ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar.

b) Skemën kryesore me treguesit teknikë dhe ekonomikë të projektit teknologjik të rafinerisë, naftësjellësit ose gazsjellësit, ku përfshihen edhe instalimet e tjera, të miratuar nga institucionet e linjës ose ekspertët kompetentë vendas apo të huaj. Institucionet ose ekspertët, kundrejt një tarife, e cila përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për hidrokarburet dhe derdhet në këtë ministri, bëjnë vlerësimin e teknologjisë së rafinerive të përpunimit të naftësjellësve ose gazsjellësve dhe pasi binden se janë në përputhje me parametrat e kërkuar të cilësisë, sigurisë teknike dhe, të mjedisit, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, japin miratimin për kalimin në fazë zbatimi të skemës kryesore të këtyre projekteve teknologjike.

c) Dokumentacionin juridik dhe teknik që vërteton arritjen e marrëveshjeve në parim ose përfundimtare për projektin me vendet e tjera në territoret e të cilit parashikohet të kalojë naftësjellësi ose gazsjellësi, për rastin kur naftësjellësi ose gazsjellësi është pjesë e tubacioneve që kalojnë transit në territorin e Republikës së Shqipërisë (në më shumë se dy vende në tokë dhe det), si dhe një skemë tërësore të objektit të ri për të gjithë shtrirjen e tij në vendet e tjera të rajonit ku parashikohet të ndërtohet objekti.

ç) Dokumentin që vërteton të drejtën dhe formën e përdorimit të sipërfaqes së tokës ku do të ndërtohet objekti, për një periudhë të barabartë me afatin e lejes së koncesionit;

d) Lejen mjedisore nga Ministria e Mjedisit.

dh) Dokumentacionin bankar që vërteton aftësinë financiare të shoqërisë për të përballuar ndërtimin e rafinerisë, naftësjellësit ose gazsjellësit.

7. Ministria përgjegjëse për hidrokarburet brenda një periudhe 30-ditore, pasi shqyrton dhe verifikon dokumentacionin e paraqitur në përputhje me kërkesat e pikës 6 të këtij vendimi, e përcjell në Këshillin e Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë për miratimin e projektit dhe të sheshit të ndërtimit.

8. Dokumentacioni i plotësuar me lejet përkatëse nga Këshilli i Rregullimit të Territorit në Republikën e Shqipërisë i dërgohet ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, për procedim të mëtejshëm.

9. a) Leja e koncesionit negociohet e përgatitet nga një grup pune me përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe Ministrisë së Mjedisit dhe me subjektin kërkues ose përfaqësuesin ligjor të tij.

b) Leja e koncesionit, së bashku me të gjitha dokumentet e përgatitura sipas këtij vendimi dhe me një kopje të autorizimit për vazhdim procedure, i dërgohet për miratim Këshillit të Ministrave.

10. Leja e koncesionit duhet të përmbajë:

a) Emrin dhe selinë e shoqërisë anonime, si dhe përfaqësuesin e organit shtetëror që ndjek dhe monitoron ndërtimin e përdorimin e rafinerisë, naftësjellësit ose gazsjellësit;

b) Vendndodhjen e rafinerisë a zonën e shtrirjes së naftësjellësit ose gazsjellësit duke përcaktuar kufijtë dhe pikat e veçanta të tij;

c) Numrin dhe datën e vendimit të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, për miratimin e kërkesës;

ç) Llojin e lejes së tregtimit dhe afatin e saj, nëse kjo shoqëri është e pajisur me këtë leje;

d) Afatin e vlefshmërisë së lejes së koncesionit dhe të drejtën për përtëritje;

dh) Të drejtën e shoqërisë për transferimin e teknologjisë;

e) Afatin e paraqitjes së dokumentacionit për marrjen e lejes së ndërtimit, afatin e përfundimit të ndërtimit të rafinerisë, naftësjellësit ose gazsjellësit dhe të fillimit të vënies në përdorim;

ë) Të drejtën e shoqërisë së pajisur me leje koncesioni për të kërkuar shtyrjen e afatit të përfundimit të ndërtimit ose vënies në përdorim të rafinerisë, naftësjellësit ose gazsjellësit, për shkak të një force madhore;

f) Të drejtën e organeve dhe institucioneve shtetërore, të ngarkuara me ligj, për kontrollin e zbatimit të projektit me cilësinë dhe në afatin e përcaktuar në projekt;

g) Të drejtën e Këshillit të Ministrave për shfuqizimin e kësaj leje koncesioni kur nga kontrollet e ushtruara nga organet dhe institucionet shtetërore, të ngarkuara me ligj, janë vërejtur shkelje ose mosrespektim të kërkesave të lejes së koncesionit, në zbatimin e parametrave teknikë, në afatin e realizimit të projektit dhe të normave mjedisore;

gj) Kategorinë e produkteve që do të prodhojë rafineria ose kategorinë e produkteve që do të transportohen në naftësjellës ose gazsjellës;

h) Detyrimet financiare, që subjekti ka ndaj shtetit dhe formën e shlyerjes së tyre;

i) Detyrimin për zbatimin e kërkesave të neneve 9 dhe 12 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, për mbajtjen e rezervës së sigurisë dhe për markën e cilësinë e nënprodukteve të naftës të prodhuara nga rafineria;

j) Të dhënat dhe afatet brenda të cilave shoqëria duhet të dërgojë në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet, në zbatim të urdhrit të ministrit përkatës;

k) Sanksionet në rast largimi, braktisjeje apo mosrealizim të investimit.

Në lejen e koncesionit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, mund të përfshihen edhe përcaktime të tjera ose detyrime të ndërsjella, për të cilat palët bien dakord.

11. Leja e koncesionit hartohet në katër kopje, nga të cilat një kopje i dorëzohet zyrtarisht shoqërisë anonime së cilës i jepet leja e koncesionit dhe nga një kopje u dërgohet Këshillit të Ministrave, ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet dhe Ministrisë së Financave.

12. a) Dhënia e lejes së koncesionit për ndërtimin dhe përdorimin e rafinerisë, naftës-jellësit ose gazsjellësit për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, bëhet kundrejt pagesës prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh nga shoqëria përkatëse, shumë e cila derdhet në llogarinë e ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

b) Të ardhurat nga pagesa për marrjen e lejes së koncesionit ndahen:

- 10 për qind përdoren për financimin e projekteve, të studimeve dhe botimeve për zhvillimin e sektorit të hidrokarbureve, për përballimin e shpenzimeve për kualifikimin dhe specializimin e personelit të strukturave dhe institucioneve që veprojnë në sektorin e hidrokarbureve, si dhe për pajisjen e këtyre sektorëve me aparatura dhe teknikë bashkëkohore, në funksion të realizimit të detyrave, por me miratimin e ministrit përgjegjës për hidrokarburet.

- 90 për qind të derdhen në Buxhetin e Shtetit.

13. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të shfuqizojë lejen e koncesionit kur gjatë kontrolleve të ushtruara nga organet dhe institucionet shtetërore, të ngarkuara me ligj, vëren shkelje ose mosrespektim të kërkesave të lejes së koncesionit, moszbatim të parametrave teknikë të projektit dhe mosrespektim të afatit të realizimit të projektit të normave mjedisore dhe detyrimeve të tjera të parashikuara në marrëveshje a që përcaktohen nga legjislacioni në fuqi.

14. a) Shoqëria e pajisur me lejen e koncesionit në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në këtë leje paraqet kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për leje ndërtimi, në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", të ndryshuar. Ndërtimi dhe vënia në funksionim e rafinerisë, naftës-jellësit ose gazsjellësit bëhet brenda afateve të përcaktuara në shkronjën "e" të pikës 10 të këtij vendimi.

b) Përdorimi i objektit dhe realizimi i veprimtarive për importimin, eksportimin, transportimin, përpunimin e tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre bëhen nëpërmjet marrëveshjeve (kontratave) me shoqëritë prodhuese të naftës bruto a me shoqëritë anonime, të cilat në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, janë të pajisura me leje koncesioni për të ndërtuar dhe/ose vënë në përdorim instalime bregdetare për transportimin, depozitimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, ose janë pajisur me leje tregtimi për ushtrimin e veprimtarisë së tregtisë me shumicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

15. Kryerja e pagesave, për ndërtimin dhe përdorimin e rafinerive të reja dhe të naftës-jellësve ose gazsjellësve, për transportimin, importimin dhe eksportimin e naftës bruto, gazit natyror dhe nënprodukteve të tyre, shlyerja e detyrimeve të tjera kontraktore, si dhe çdo detyrim doganor dhe fiskal, për këto veprimtari, të bëhet nëpërmjet dokumentacionit bankar.

16. Veprimtaria e subjekteve, të pajisuara me leje koncesioni për ndërtimin dhe përdorimin e rafinerive, naftës-jellësve dhe gazsjellësve, të monitorohet nga strukturat e ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet dhe nga institucione e struktura të tjera shtetërore, të ngarkuara me ligj.

17. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës, Ministri i Financave dhe Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.554, datë 2.7.2004

**PËR NJËSIMIN E GRADAVE USHTARAKE NË FUNKSIONET ORGANIKE NË TË
GJITHA NIVELET E HIERARKISË SË KOMANDIMIT DHE TË DREJTIMIT TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr.9171, datë 22.1.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Njësimin e gradave ushtarake me funksionet organike në të gjitha nivelet e hierarkisë së komandimit e të drejtimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2. Gradat ushtarake për ushtarakët që shërbejnë në Ministrinë e Mbrojtjes, Shtabin e Përgjithshëm, Shërbimin Informativ Ushtarak, përfaqësinë ushtarake me mision në NATO dhe strukturat jashtë Forcave të Armatosura, njësohen me funksionet organike, të përcaktuara në lidhjet nr.1 dhe nr.1/1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Gradat ushtarake për ushtarakët që shërbejnë në repartet dhe institucionet e pavarura, në varësi të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, njësohen me funksionet organike, të përcaktuara në lidhjet nr.2 dhe 2/1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Gradat ushtarake, për ushtarakët që shërbejnë në forcat tokësore dhe repartet në varësi të tyre, njësohen me funksionet organike, të përcaktuara në lidhjet nr.3 dhe nr.3/1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

5. Gradat ushtarake, për ushtarakët që shërbejnë në Forcat Detare dhe repartet në varësi të tyre, njësohen me funksionet organike, të përcaktuara në lidhjet nr.4 dhe nr.4/1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

6. Gradat ushtarake, për ushtarakët që shërbejnë në Forcat Ajrore dhe repartet në varësi të tyre, njësohen me funksionet organike, të përcaktuara në lidhjet nr.5 dhe nr.5/1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

7. Gradat ushtarake, për ushtarakët që shërbejnë në Komandën e Mbështetjes Logjistike dhe repartet në varësi të saj, njësohen me funksionet organike, të përcaktuara në lidhjet nr.6 dhe nr.6/1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

8. Gradat ushtarake, për ushtarakët që shërbejnë në Komandën e Doktrineve dhe të Stërvitjes dhe repartet në varësi të saj, njësohen me funksionet organike, të përcaktuara në lidhjet nr.7 dhe nr.7/1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

9. Njësimi i gradave ushtarake me funksionet organike, në të gjitha nivelet e hierarkisë së komandimit e të drejtimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të përfundojë brenda vitit 2004

10. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

11. Vendimi nr.427, datë 12.9.2002 i Këshillit të Ministrave “Për njësimin e gradave ushtarake në funksionet organike në të gjitha nivelet e hierarkisë së komandimit e të drejtimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

(OFICERA)

GRUP FUNKSIONET ORGANIKE TE NJESUARA ME GRADAT USHTARAKE NE MINISTRINE E MBROJTJES
SHTABIN E PERGJITHSHEM, SHIU, STRUKTURA JAShte FA DHE PERFAQSIA USHTARAKE ME MISION NE NATO

LIDHJA NR.1

Nr. EMERTIMI / FUNKSIONEVE	MM SHIP DREJTORI TE SHIUETJ DHE GRADAT PER FUNKSION													Part. Usht. Mision NATO
	MM	SHIP Kabineti	J1	J2	J3	J4	J5	J6	J7	J8	J9	Shtabi jashtes FA	SHIU	
1 Drejtor	Kolonel	Kolonel	Kolonel	Kolonel	Kolonel	Kolonel	Kolonel	Kolonel	Kolonel	Kolonel	Kolonel	Kolonel	Kolonel	
2 Zv/Drejtor			N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	
3 Shef Kabineti/Insp. pergj		Kolonel												Kolonel
4 Zv/Perf. Usht. mision ne NATO			N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	
5 Pergjegjes Sektori/Zyre	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	
6 Inspektor (of.shtabi) pergj.	N/Kol.	N/Kol.												
7 Pergjegjes Sektori														
8 Pergjegjes Zyre														
9 Pergjegjes zyres personelit														
10 Keshilltar	Kolonel	Kolonel												
11 Oficer Shtabi		N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.			N/Kol.
12 Specialist	Major	Major	Major	Major	Major	Major	Major	Major	Major	Major	Major	deri-Maj.	Major	
13 Atashe Ushtarak Niv.I												Kolon.		
14 Atashe Ushtarak Niv.II												N/Kol.		
15 Adjutant i Gj. Lejtnant		Major												
16 Adjutant i Gj. Majorit		Kapiten												
17 Adjutant i Gj. Brigades		Toger												

MM, SHP, DREJTORITE, SHIU, ETJ, DHE GRADAT PER FUNKSION

		MM SHP DREKTORITE SHIUETJ DHE GRADAT PER FUNKSION													
E	EMERTIMI I FUNKSIONEVE	MM	SHP Kabineti	J1	J2	J3	J4	J5	J6	J7	J8	J9	SHIU	Perf. Usht. Mision NATO	
1	Keshilltar														
2	N/Ot (J 1-J9) Admin. Sekr.oper.														
3	N/of.admin./sekret/op./shofer														
4	N/officer furnizimi (makazin.)														
5	N/sekretar/operator/prot.arxiv.	deri-Kap.												K/Kapt.	
6	N/officer Sigurie/vezhgjim...		deri-Kap.											Telar	
7	Shofer (shoqerues)													T-Rresh T-Kapt.	

(OFICERA)

**GRUP FUNKSIONET ORGANIKE TE NJESUARA ME GRADAT USHTARAKE TE
REPARTET AUTONOME NE VARTESI TE DREJTPERDREJTE TE SHITABIT TE PERGJITHSHEM TE FA**

JDHJA NR.2

Nr.	EMERTIMI I FUNKSIONEVE	REPARTET AUTONOME TE SHIRDHE GRADAT PER FUNKSION													Toge	
		Qendra e Shitypit	QBD	BM/C	SUQD	Gendrar e FA	IS/MS e FA	IS/MS e FA	IS/MS e FA	IS/MS e FA	IS/MS e FA	IS/MS e FA	IS/MS e FA	IS/MS e FA		
1	Drejtor	N/Kol.			Kolon.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.								
2	Zv/Drejtor				N/Kol.	Major										
3	Komandant			Kolonel												
4	Zv/Komandant			N/Kol.												
5	Shf Shtabi			N/Kol.												
6	Shf (ne Institucione Q.)				Major	Major										
7	Shf (pergi) Dege/Sektori															
8	Inspektor (of. shtab) pergi.		N/Kol.													
9	Zv/ Shf															
10	Shf (Sek.) Q.Rr./MNZ/Kordin.															
11	Shf Seksioni (S3)			Kapiten		Kapiten										
12	Shf (pergjegjes) Zyre (sh.p)			Kapiten	Major											
13	Shf Sherbimi Shendet.		N/Kol.													
14	Shf/Kom. Rep. Shendet.			Major	Major											
15	Shf/Kom. Qend. (Ork.Gr.Art.)		Kolonel			Major										
16	Zv.Shf/Kom. Qendre			Kapiten												
17	Oficer Shtabi															
18	Shf Trupes Mesimore															
19	Specialist (Of. Sigurie)															
20	Atashe Ushtarak Niv.I															
21	Atashe Ushtarak Niv.II															
22	Mjek/k/infermier/farmacist															
23	Kryeredaktor	Major														
24	Redaktor	deri-Maj.														
25	Gazetar	deri-Maj.														

(OFICERA)

GRUP FUNKSIONET ORGANIKE TE NJESUARA ME GRADAT USHTARAKE NE FORCAT TOKESORE

JDHJA NR.3

KOMANDA, SHITABI, NJESITE, REPARTIET DHE GRADAT PER FUNKSION																
Nr.	EMERTIMI I FUNKSIONEVE	Kom- Dhe Shtabi	Br. Reag. Shp.	Regj. Koman- Xhieniere	Br. Xhieniere	Br. K Br. AT me Rezerv	Batalion Aktiv Rezerv	Shitab e Shenues Trupes	Komp. Shenues Baten	Komp. Baten Mb. Zjarr	Toge Shend.	Toge	Grup Special Mb. Zjarr			
1	Komandant															
2	Zv/Komandant	Kolonel	Kolonel	Kolonel	Kolonel	Kolonel	N/Kol.	Kolonel	Major	Kapit.	N/T-Tg.	Kapit.	N/T-Tg.			
3	Shf Shtabi	Kolonel	Kolonel	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	Major	N/Kol.	Toger							
4	Shf Dege (EMZ e FT)	N/Kol.														
5	Zv.Shf Dege (EMZ e FT)					Major										
6	Shf Seksion (S3)(EMZ Br.SH)	N/Kol.					Major		Kapiten							
7	Shf Zyrt i Komandantit	N/Kol.		Major	Major	Major										
8	Shf Seksioni	Major	Major	Major	Major	Major	Kapiten	Major	Major		Kapiten					
9	Shf i Trupes Mesimore							N/Kol.								
10	Keshilltar	Major														
11	Oficer Shtabi	Major	Major			Major	Kapiten									
12	Specialist (Inspektor)	Kap-Maj.	Kapit.	Kapiten	Kapiten	Kapiten	Tog-Kap									
13	Adjutant i Komandantit	Kapiten	Toger													
14	Instruktur							deri-Maj.								
15	Oficer Ekzekutiv/Of. Dr. Zj.															
16	Shf n/rep. Mjekesor						Kapiten		Kapiten							
17	Mjek.Inxh.,Jurist,Finance	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.	Kapiten	Kapiten	Kapiten							

GRUP FUNKSIONET ORGANIKE TE NJESUARA ME GRADAT USHTARAKE NE FORCAT TOKESORE

HJA NR.3/1

[illegible]

(OFICERA)

GRUP FUNKSIONET ORGANIKE TE NJESUARA ME GRADAT USHTARAKE NE FORCAT DETARE

IDHJA NR.4

KOMANDA SHTABI NJESITË, REPARTET DHE GRADAT PER FUNKSION														
Nr.	EMERTIMI I FUNKSIONEVE	Kom. Dhe Shtabi	Shkolla e Trupes	Sherb. Hidro-grafik	Distrikt Datar	Flotile	Baze Norm	Varo. Bazim	Spec. Anije Kanban	Batal. Logjist	Korpo. V/Baz (Stacion)	An. Patr. An. MM An. GUDV An. TM	Org. L. Bord	Poste R/T
1	Komandant		K/R I	K/R II	K/R I	K/R II	K/R III	K/Lejt.	K/R III	K/R II	K/Lejt.	K/Lejt.	N/L-Lejt.	Lejtn.
2	Zv/Komandant	K/R I	K/R II	K/R III	K/R II	K/R III	K/Lejt.	Lejtnant		K/R III	Lejtnant			N/Lejtn.
3	Shëf Shtabi	K/R I			K/R II	K/R III								
4	Shëf Dege	K/R II								K/R III				
5	Shëf Seksion (S3)					K/R III								
6	Shëf Zyre i Komandantit	K/R II			K/R III									
7	Shëf Seksioni	K/R III	K/R III	K/Lejt.	K/R III	K/Lejt.	Lejtnant			K/Lejt.				
8	Shëfi Trupes Mesimore		K/R II								K/R III			
9	Shëf Qendre (Grup)				Lejtnant									
10	Zv/Shëf Qendre													
11	Shëf Stacioni													
12	Keshilltar	K/R III			K/Lejt.									
13	Oficer Shtabi/Sp.Inspektor	K/R III												
14	Specialist	K/Lejt.	Lejtnant	Lejtnant	K/Lejt.	Lejtnant				Lejtnant				
15	Adjutant i Komandantit	K/Lejt.												
16	Instruktur		deri-K/R III											
17	Mjek,Inxh.,Jurist,Finance		deri-K/R III		4-K/R III	K/Lejt.			K/Lejt.	K/Lejt.	K/Lejt.			
18	Drejtor									K/R II				
19	Zv./Drejtor									K/R III				
20	Shëf Reparti									K/Lejt.				
21	Komandant Doku									K/Lejt.				

(OFICERA)

GRUP FUNKSIONET ORGANIKE TE NJESUARA ME GRADAT USHTARAKE NE FORCAT AJRORE

IDHJA NR.5

Nr. EMERTIMI I FUNKSIONEVE	KOMANDA SHITABI NJESIE REPARTET DHE GRADAT PER FUNKSION														
	Kom. Dhe Shtabi	Gendra Qendra Operac. SAR	Gendra Qendra Operac. Shtabi	Shkalla e Trupes	Br. Mbrojtje Ajrore	Regjia e Fletkops	Grupi Operac. Ajror	Komandant	Komandant	Komandant	Komandant	Komandant	Komandant	Komandant	Komandant
1 Komandant	Kolonel			Kolonel	Kolonel	Kolonel	N/Kol.	Kolonel	N/Kol.	Kolonel	N/Kol.	Kolonel	N/Kol.	Kolonel	N/Kol.
2 Zv/Komandant				N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.
3 Kom katershe /ekuipazhi /cifti															
4 Shef Shtabi	Kolonel			N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.
5 Shef Dege	N/Kol.														
6 Shef Seksion (S3)															
7 Shef Zyre i Komandantit	N/Kol.														
8 Shef Seksioni	Major	Kapiten	Major	Major	Major	Major	Major	Major	Major	Major	Major	Major	Major	Major	Major
9 Shef Trupes Mesimore															
10 Shef Qendre		Major	N/Kol.	Major	Major	Major	Major	Major	Major	Major	Major	Major	Major	Major	Major
11 Zv/Shef Qendre		Kapiten													
12 Shef Stacioni Qendrore															
13 Shef Seksioni Riparimi															
14 Shef Reparti															
15 Keshilltar	Major														
16 Oficer Shtabi (S3)	Major														
17 Specialist	Kapiten														
18 Adjutant i Komandantit	Kapiten														
19 Pilot/aviodrejtes/fluturu.															
20 Instruktor Pilot															
21 Instruktor															
22 Mjek,Inxh.,Jurist,Finance	deri-Maj.														
23 Koordinatore															
24 Kom. Radari/Shef P.dhenave															

GRUP FUNKSIONET ORGANIKE TE NJESUARA ME GRADAT USHTARAKE NE FORCAT AJRORE

[illegible]

(OFICERA)

GRUP FUNKSIONET ORGANIKE TE NJESUARA ME GRADAT USHTARAKE NE KOM.LOGJISTIKE

LIDHJA NR.6

KOMANDA SHTABI, NJESIT E REPARTET DHE GRADAT PER FUNKSION												
NR. EMERTIMI I FUNKSIONEVE	Kom. Dhe Shtabi	Br. Furq. zimi	Br. Transp.	Stafet (Baz)	Stafet Trupes	Stafet Trupes	Stafet Trupes	Stafet Trupes	Stafet Trupes	Stafet Trupes	Stafet Trupes	Stafet Trupes
1 Komandanti/Drejtor/Shef	Kolonel	Kolonel	Kolonel	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.
2 Zv/Komandanti/Drejtor	Kolonel	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.
3 Shef Shtabi	Kolonel	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.
4 Shef Dege/Reparti	N/Kol.			Major								
5 Shef Seksion (S3)	N/Kol.			Major								
6 Shef Zyre i Komandantit	N/Kol.											
7 Shef Seksion	Major	Kap-Maj	Kap-Maj	Kapiten	Major	Major	Kapiten	Kapiten	Kapiten	Kapiten	Kapiten	Kapiten
8 Shef i Trupes Mesimore	Major				N/Kol.							
9 Keshilltar	Major											
10 Oficer Shtabi	Major	Kapiten	Kapiten	Kapiten	Kapiten	Kapiten	Kapiten	Kapiten	Kapiten	Kapiten	Kapiten	Kapiten
11 Specialist	Kapiten	Kapiten	Kapiten	Kapiten	deri-Kap.	deri-Kap.	deri-Kap.	deri-Kap.	deri-Kap.	deri-Kap.	deri-Kap.	deri-Kap.
12 Adjutant i Komandantit	Toger											
13 Instruktor												
14 Farmacist	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.
15 Mjek,Inxh.,Jurist,Finance	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.	deri-Maj.

GRUP FUNKSIONET ORGANIKE TE NJESUARA ME GRADAT USHTARAKE NE KOM.LOGJISTIKE

DHJA NR.6/1

[illegible]

(OFICERA)

GRUP FUNKSIONET ORGANIKE TE NJESUARA ME GRADAT USHTARAKE NE KOM.DOKTR.ST.

LIDHJA NR.7

LDHJA NR.7

		KOMANDA SHITABI NJESITE REPARTJET DHE GRADAT PER FUNKSION															
Nr.	EMERTIMI I FUNKSIONEVE	Kom. Dhe Shtabi	Qendra Studim. "Sk"	Univers. Ushtar. "Sk"	Akad. a Mbrojtje	Atestim. Mbrojtje	Stafi Shtabi	Stafi Shtabi	Stafi Shtabi	Kurseve Grupave	Kurseve Grupave	Komp. Qendra Shtabi	Qendra Shtabi	Qendra Shtabi	Qendra Shtabi	Qendra Shtabi	Qendra Shtabi
1	Komandanti			Kolonel	Kolonel	Kolonel	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	M.-N/K	Kapiten Kapit.		Toger				
2	Zv/Komandanti	Kolonel		N/Kol.	Kolonel	N/Kol.		Major			Toger						
3	Shef Shtabi	Kolonel					N/Kol.										
4	Shef Dege (pergjegj. Dep.)	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.	N/Kol.			Major									
5	Shef Seksion (S3)	N/Kol.		Major				Major									
6	Shef Zyre i Komandantit	Major		Major	N/Kol.	Major	Major	Kapiten Kapit.					Major				
7	Shef Seksion		Kolonel														
8	Shef Qendra (pergjegjes)		M.-N/K														
9	Zv/Shef Qendra																
10	Shef Departamenti	Major			Kolonel												
11	Keshilltar	Major															
12	Oficer Shtabi	Major		Major				Kapiten									
13	Oficer taktik batalion			Major													
14	Oficer taktik kompanie			Kapiten													
15	Specialist	Kapiten	M.-N/K	Major	Major	Kapiten Kapit.	Tog-Kap	Tog-Kap									
16	Adjutant i Komandantit	Toger															
17	Petagog Pergjegjes				M.-N/K	K.-Major				M.-N/K							
18	Petagog				M.-N/K	Kapiten											
19	Asistent Petagog			Kapiten													
20	Mjek,Inxh.,Jurist,Finance	deri-Major					deri-Major	deri-Kap.					deri-Major				
21	Punonjes Shkencor		N/Kol.														

(N/OICERA)

GRUP FUNKSIONET ORGANIKE TE NJESUARA ME GRADAT USHTARAKE NE KOM.DOKTR.ST.

LIDHJA NR. 7/1

Nr.	EMERTIMI I FUNKSIONEVE	Kom. Dhe Shtabi	Universiteti "Sk"	Akademik a Mbrojtje	Akademik a Mbrojtje	Brigada e Shtetit	Batalion	Komandant	Qendër Shtet	Topo Shtet	Grup					
		K/Kapler	K/Kapler	K/Kapler	K/Kapler	K/Kapler	Kapler	Rr-Kapler	Rr-Kapler	Rr-Kapler	Tel.-Rr.	N/Tel.				
1	Keshilltar	K/Kapler	K/Kapler													
2	Komandant (Pergjegjes)															
3	ZV/Komand. (Ndihmes Kom.)															
4	N/Of. (G.S 1-9) Adm. Sekr.oper.	Rr-Kap.	T-Kapt.	T-Kapler	T-Kapler	Rr-Kap.	Rr-Kapler									
5	Shef (Zyre, Seksion)		Kapler				Kapler									
6	K/Infermier								Kapler							
7	Infermier/Laborant/farmacist		Reshl.						Reshl.							
8	N/Of./Sp./teknik.ripar.mirimb.															
9	N/Oficer furnizimi (makazin.)		Reshl.	Reshler				Reshler								
10	Shofer (shoferues)	T-Kapt	T-Reshl.	T-Reshl.	T-Reshl.	T-Reshl.		T-Reshl.			N/T-Tel.					
11	Pedagog															
12	N/Of./Logaritar/Arketar															
13	N/Ofic. Taktike/batal./komp.															
14	N/Of.Servitje/Instruktur	Rr-Kapt.	Kapler	Rr-Kapt.	T-Reshl.			Tel.			Tel.					
15	K/Mekanik/Motorrist							Tel.			Tel.					
16	K.Kuzhinier/Kuzhinier							Tel.			Tel.					

VENDIM
Nr.555, datë 16.7.2004

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITI 2004, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR KOMUNE, NË KOMUNËN HUDENISHT, TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 7 e 10 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, t’i shtohet fondi prej 1 400 00) (një milion e katërqind mijë) lekësh, për financimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar komune, në komunën Hudenisht, të qarkut të Korçës, që u zhvilluan më datë 4.7.2004.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Financave dhe kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
Bulevardi “Zhan d’Ark”, pranë ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

DOLI NGA SHTYPI

PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE 1500

Doli nga shtypi më 20.8.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 200 lekë